FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 220

Tiranë – E mërkurë, 16 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimin e Ujërave nr. 9, datë 10.10.2016	Për kontrollin zyrtar të trikinelës.....	22839
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 11909/1, datë 18.10.2016	Për një shtesë dhe ndryshim në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 33, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë".....	22851
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 62, datë 4.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 2, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale.....	22851
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 63, datë 4.11.2016	Me objekt: Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 582 akti, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. - Konstatimin e cenimit të aksesit si rezultat i mosdërgimit nga administrata gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë të ankimit kundër vendimit nr. 700 akti, datë 20.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë të rekursit kundër vendimit nr. 582 akti, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. - Detyrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor material dhe moral në shumën 1.500.000 lekë, të shkaktuar nga veprimet e qëllimshme të administratës shtetërore.....	22859
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 64, datë 4.11.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 2466, datë 18.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 104, datë 16.1.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	22863

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 169, datë 31.10.2016	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".....	22868
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 170, datë 31.10.2016	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.....	22869
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 31.10.2016	Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.9.2011, "Mbi licencimin e shoqërisë Euron Energy Group" sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike" nr. 187, seria T11P.....	22875
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 31.10.2016	Mbi fillimin e procedurës për lënien peng të aseteve të shoqërisë "Denas Power" sh.p.k., në favor të bankës "Societe Generale Albania" sh.a.....	22876
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 31.10.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane", me fuqi të instaluar 2850 kW.....	22877
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Besho Muhametaj.....	22877

UDHËZIM
Nr. 9, datë 10.10.2016

PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË TRIKINELËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim përcakton rregullat për monitorimin e rregullt të derrave shtëpiakë, derrave të egër, kuajve dhe dhelprave apo kafshë të tjera përcaktuese, si një mjet i rëndësishëm për të vlerësuar ndryshimet në përhapjen e sëmundjes së trikinelës.

2. Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Trikinela" është nematodi që i përket specieve të gjinisë trikinela;

b) "Kushte strehimi të kontrolluara" është tipi i mbarështimit të kafshëve ku derrat janë mbajtur gjatë të gjithë kohës nën kushte të kontrolluara nga operatori i biznesit ushqimor në lidhje me të ushqyerin dhe strehimin;

c) "Kompartiment" është një grup stallash në të cilat zbatohen kushtet e kontrolluara të strehimit;

d) "Autoriteti kompetent" është Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për kontrollin e karkasave të mishit dhe marrjes së mostrave prej tyre. Kontrolli i mishit në thertore kryhet nga veterineri i pushtetit vendor.

II. Detyrimet e autoritetit kompetent dhe të operatorëve të biznesit ushqimor

1. Mostrat për analizë merren te karkasat e derrave në thertore, si pjesë e ekzaminimeve postmortem. Ekzaminimi për trikinel kryhet sistematikisht, për:

a) të gjitha karkasat e dosave për mbarështim dhe të derrave të egër ose të paktën 10% e karkasave të kafshëve të dërguara për therje çdo vit nga secila fermë, e cila është zyrtarisht e njohur se aplikon kushtet e strehimit të kontrolluar;

b) të gjitha karkasat që vijnë nga ferma, të cilat nuk janë të njohura zyrtarisht që zbatojnë kushte strehimi të kontrolluara.

Një mostër merret nga çdo karkasë dhe mostra ekzaminohet për trikinelë, në një laborator të përcaktuar nga autoriteti kompetent, duke përdorur një nga metodat e mëposhtme të zbulimit:

a) metodë reference zbulimi, e përcaktuar në kapitullin I, të shtojcës I; ose

b) një metodë ekuivalente e zbulimit, e përcaktuar në kapitullin II, të shtojcës I.

2. Karkasat e kuajve, derrit të egër dhe specie të tjera të kafshëve të kultivuara dhe të egra, të prekshme nga infektimi me trikinel do të mostrohen në mënyrë sistematike në thertore apo stabilimentet e trajtimit të kafshëve të gjahut, si pjesë e ekzaminimit postmortem.

Nga secila karkasë do të merret një mostër dhe mostra do të ekzaminohet në përputhje me shtojcat I dhe III në një laborator të përcaktuar nga autoriteti kompetent.

3. Deri sa të dalin rezultatet e ekzaminimit të trikinelës dhe duke parashikuar që gjurmueshmëria e plotë është garantuar nga operatori i biznesit ushqimor, karkasat e derrave shtëpiakë dhe kuajve mund të priten (ndahen) maksimumi në 6 pjesë në thertore ose në një repart prerjeje në të njëjtën ndërtesë.

Në përjashtim nga paragrafi i mësipërm dhe pas miratimit nga autoriteti kompetent, këto karkasa mund të priten (ndahen) në një repart prerje bashkëngjitur thertores ose e ndarë prej saj, me kusht që:

a) procedura kontrollohet nga autoriteti kompetent;

b) një karkasë ose pjesët e saj nuk kanë më shumë se një repart të prerjes si destinacionin e vet;

c) karkasa të shkojë vetëm në një repart prerjeje që ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

d) Në rast rezultati pozitiv, të gjitha pjesët e karkasës deklarohen të papërshtatshme për konsum njerëzor.

III. Përjashtimet

1. Pavarësisht përcaktimit në kreun II, pika 1, të këtij udhëzimi, mishi i derrave shtëpiakë, i trajtuar me ngrirje në përputhje me shtojcën II nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent, nuk i nënshtrohet ekzaminimit për trikinelë.

2. Pavarësisht përcaktimit në kreun II, pika 1, të këtij udhëzimi, nuk ekzaminohen për trikinelë

karkasat dhe mishi i gicave të pashkëputur, në moshë 5-javësh.

3. Pavarësisht përcaktimit në kreun II, pika 1, të këtij udhëzimi, karkasat e mishit të derrave shtëpiakë që vijnë nga ferma që zbatojnë kushte të kontrolluara strehimi nuk ekzaminohen për trikinelë, në qoftë se:

a) asnjë infeksion autokton i trikinelës në derrat shtëpiak të mbajtura në stalla që njihen zyrtarisht se zbatojnë kushtet e strehimit të kontrolluar nuk është zbuluar në 3 vitet e fundit dhe gjatë kësaj kohe janë bërë testime të vazhdueshme sipas përcaktimeve të kreut II të këtij udhëzimi; ose

b) të dhënat e mëparshme për testet e vazhdueshme të realizuara në popullatën e derrave të therur sigurojnë të paktën 95% besueshmëri që prevalenca e trikinelës nuk kalon një për një milion në këtë populacion.

IV. Ekzaminimi i trikinelës

1. Karkasat e referuar në kreun II, të këtij udhëzimi ose pjesë të tyre, me përjashtim të atyre të referuara në paragrafin e dytë të kreut II, pika 3, të këtij udhëzimi, nuk dalin nga stabilimenti përpara se rezultatet e ekzaminimit për trikinelë të jenë negative.

Në mënyrë të ngjashme, pjesë të tjera të një kafshe të përcaktuara për konsum njerëzor ose ushqim për kafshë, i cili përmban inde të muskujve të strijuar, nuk dalin nga stabilimenti përpara se rezultatet e ekzaminimit për trikinelë të jenë negative.

2. Mbetjet e kafshëve, si dhe nënproduktet e tyre të destinuara jo për konsum njerëzor dhe që nuk përmbajnë inde të muskujve të strijuar, dalin nga stabilimenti përpara se rezultatet e ekzaminimit për trikinelë të kenë përfunduar.

Megjithatë, veterineri zyrtar mund të kërkojë ekzaminim për trikinelë ose kryerjen e një trajtimi paraprak të nënprodukteve përpara se të dalin jashtë stabilimentit.

V. Trajnimi

Autoriteti kompetent dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), sigurojnë që të gjithë personat e përfshirë në ekzaminimin e mostrave për zbulimin e trikinelës, të trajnohen në mënyrë të përshtatëshme dhe të marrin pjesë në:

a) një program kontrolli cilësor të testeve që përdoren për zbulimin e trikinelës; dhe

b) një vlerësim të rregullt të testeve, regjistrave dhe procedurave të analizave të përdorura në laborator.

VI. Metodat e zbulimit

1. Metodat e zbulimit të përcaktuara në krerët I dhe II, të shtojcës I, të këtij udhëzimi, përdoren për ekzaminimin e mostrave të referuar në kreun II të këtij udhëzimi, kur ka arsye për të dyshuar për infektim me trikinelë.

2. Të gjitha kampionet pozitive dërgohen në ISUV për përcaktimin e llojit të trikinelës që ka shkaktuar infektimin.

VII. Planet e kontingjencës

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore harton planin e kontingjencës, ku përcaktohen të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, në rastet kur mostrat e referuara në kreun II të këtij udhëzimi dalin pozitive për trikinelë. Plani duhet të përfshijë:

a) gjurmueshmërinë e karkasave të infektuara, si dhe të pjesëve të tyre që përmbajnë muskuj;

b) masat që do të merren për karkasat e infektuara dhe pjesët e tyre;

c) investigimin për burimin e infektimit dhe ndonjë përhapje të mundshme te fauna e egër;

d) masat që do të merren në dyqanet e shitjes me pakicë të mishit apo te konsumatorët;

e) masat që do të merren atëherë kur karkasat e infektuara nuk mund të identifikohen në thertore;

f) përcaktimin e llojit të trikinelës që ka shkaktuar infektimin.

VIII. Kërkesat për importin

Mishi që përmban muskuj të strijuar nga speciet e kafshëve që mund të jenë mbartës të trikinelës, importohen në Republikën e Shqipërisë vetëm në qoftë se përpara eksportit është kryer ekzaminimi për trikinelë, në përputhje me kushtet ekuivalente të përcaktuara në krerët II ose III të këtij udhëzimi, në vendin ku kafshët janë therur.

IX. Zbatimi dhe hyrja në fuqi

1. Urdhri nr. 427, datë 1.10.2008, "Mbi miratimin e rregullores "Mbi rregullat specifike për kontrollin zyrtar të trikinelës në mish", shfuqizohet.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIN E UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCA I
METODAT E ZBULIMIT

KREU I
METODA REFERENCË E ZBULIMIT

Metoda me përzierës magnetik për mostrat e tretura

1. *Pajisje dhe reagjentë*

a) Thikë ose gërshërë dhe pincetë për copëtimin e mostrave.

b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajnë mostrat afërsisht prej 2 g të mishit, apo mjete të tjera, duke dhënë garanci ekuivalente në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.

c) Blendër me thikë copëtimi. Kur mostrat janë më të mëdha se 3 g, përdoret copëtues mishi me hapje 2–4mm ose gërshërë. Në rast se mostra është mish i ngrirë ose gjuhë (pas largimit të shtresës sipërfaqësore, e cila nuk mund të tretet) është i nevojshëm një copëtues mishi dhe madhësia e mostrës duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme.

d) Përzierës magnetik me pjatë ngrohëse të kontrolluar në mënyrë termostatike dhe me thupër përzierje të veshur me teflon afërsisht 5 cm të gjatë.

e) Hinkë konike ndarëse prej qelqi, me kapacitet të paktën 2 litra, preferohet me tapë sigurie tefloni.

f) Mbajtëse, shtrënguese dhe unaza.

g) Sitë me madhësi rrjete 180 mikron, diametër të jashtëm 11 cm, me rrjetë inoks.

h) Hinka, me diametër të brendshëm jo më pak se 12 cm, për të mbështetur sitat.

i) Bejkër qelqi, me kapacitet 3 litra.

j) Cilindra matës prej qelqi me kapacitet 50-100 ml ose tuba centrifuge.

k) Një trikinoskop me tavolinë horizontale ose një stereomikroskop me substancë që përçon burimin e dritës me intensitetin e duhur.

l) Pjata petri me diametër 9 cm (për përdorim me një stereomikroskop), të vizatuara në pjesën e poshtme të tyre me kuadrate ekzaminimi 10x10 mm^2, duke përdorur një instrument të mprehtë.

m) Enë për numërimin e larvave (për përdorim me një trikinoskop) të bëra nga pjata akriliku me trashësi 3 mm, si më poshtë:

i) Pjesa e poshtme e enës të jetë 180 x 40 mm, shënuar me kuadrate;

ii) anët të jenë 230 x 20 mm;

iii) fundet të jenë 40 x 20 mm. Pjesa e poshtme dhe skajet duhet të futen në mes të anëve, për të formuar dy doreza të vogla në skaje. Ana e sipërme e pjesës së poshtme duhet të ngrihet 7 deri 9 mm nga baza e kornizës së formuar nga anët dhe skajet. Komponentët duhet të bashkohen së bashku me ngjitës të përshtatshëm për materialin.

n) Fletë alumini.

o) Acid klorhidrik 25%.

p) Pepsinë, fuqia: 1:10 000 NF (US National Formulary), që i korrespondon 1:12 500 BP (British Pharmacopoeia) dhe 2 000 FIP (Fédération internationale de pharmacie) ose lëng i stabilizuar pepsine me minimumi 660 European Pharmacopoeia njësi/ml.

q) Ujë i nxehtë rubineti 46–48°C.

r) Peshore me saktësi të paktën 0.1 g.

s) Tabaka metalike, kapaciteti 10–15 litra, për të mbledhur lëngun tretës.

t) Pipeta në masa të ndryshme (1, 10 dhe 25 ml), si dhe mbajtëse pipete.

u) Termometër me saktësi 0.5°C, nga 1–100°C.

v) Sifon për ujin e rubinetit.

2. Mbledhja e mostrave dhe sasia që duhet tretur

a) Nga karkasa e plotë e derrit shtëpiak merret një mostër të paktën 1 g nga kolona e diafragmës në kalimin për në pjesën e forcuar. Për marrjen e kësaj mostre mund të përdoren pinceta të veçanta trikinea me saktësi 1.00 dhe 1.15 g.

Në rast se janë dosa dhe harça race, merret kampion më i madh të paktën 2 g nga kolona e diafragmës në kalimin për në pjesën e forcuar.

Në mungesë të kolonës së diafragmës, një mostër që është dy herë madhësia 2 g (ose 4 g në rastin e dosave të mbarështimit dhe derrave) do të merret nga pjesa e brinjëve apo pjesa e gjoksit të diafragmës, ose nga muskujt e nofullës, gjuha apo muskujt e barkut.

b) Për mishin e prerë, merret një mostër të paktën 5 g nga muskujt e strijuar, që përmban pak dhjamë, kur është e mundur të merret ngjitur me brinjët ose tendinat. Një mostër e madhësisë së njëjtë duhet të merret nga mishi që nuk është përcaktuar të gatuhet tërësisht ose lloje të tjera përpunimi posttherje.

c) Për mostrat e ngrira, merren të paktën 5 g inde muskuli i strijuar.

Pesha e mostrës varet nga fakti se sa i pastër është mishi nga dhjami apo indet muskulare. Vëmendje duhet t'i kushtohet kur merret kampion nga gjuha për të shmangur kontaminimin me shtresat sipërfaqësore të gjuhës që nuk mund të tretet dhe mund të pengojë leximin e sedimentit.

3. Procedura

I. Bashkim i plotë (100 g kampion në një kohë)

a) 16 ± 0.5 ml të acidit klorikhidrik shtohet në një bejker 3 litra që përmban 2.0 litra ujë rubineti të ngrohur më parë në temperaturë 46–48°C; në bejker vendoset një thupër për përzierje, bejkeri vendoset në pjatën e parangrohur dhe fillon përzierja.

b) shtohet 10 ± 0.2 g pepsinë ose 30 ± 0.5 ml pepsinë e lëngshme.

c) 100 g mostër e marrë sipas pikës 2 copëtohet në copëtuese.

d) Mishi i copëtuar kalohet në bejker 3 litra me ujë, pepsinë dhe acid klorihidrik.

e) Thika e copëtuesit zhytet herë pas here në lëngun tretës në bejker dhe ena e copëtuesit shpëlahet me sasi të vogla të lëngut tretës për të larguar çdo sasi mishi që mund të jetë ngjitur.

f) Bejkeri mbulohet me fletë alumini.

g) Përzierësi magnetik duhet të rregullohet, në mënyrë të tillë që të mbajë një temperaturë konstante 44–46°C gjatë gjithë veprimit. Gjatë përzierjes, lëngu tretës duhet të rrotullohet me shpejtësi të lartë të mjaftueshme për të krijuar një fugë të thellë, por pa spërkatur.

h) Lëngu tretës përzihet derisa grimcat e mishit zhduken (afërsisht 30 minuta). Përzierja ndërpritet dhe lëngu tretës hidhet nëpërmjet sitës në hinkën e sedimentimit. Tretja mund të kërkojë kohë të gjatë (jo më shumë se 60 minuta) në përpunimin e disa llojeve të mishit (gjuhë, mish gjahu etj.).

i) Procesi i tretjes konsiderohet i kënaqshëm në qoftë se jo më shumë se 5% e peshës së mostrës fillestare mbetet në sitë.

j) Lëngu i tretjes lejohet që të qëndrojë në hinkë për 30 minuta.

k) Pas 30 minutash, një mostër prej 40 ml e lëngut tretës vendoset me shpejtësi në një cilindër matës ose në tubin e centrifugës.

l) Lëngu tretës, si dhe të tjera mbetje të këtyre lëngjeve ruhen në një enë deri sa të dalin rezultatet.

m) Mostra prej 40 ml lihet të qëndrojë për 10 minuta. Pastaj 30 ml nga shtresa sipërfaqësore largohet me kujdes nëpërmjet thithjes, për të larguar shtresat e sipërme, dhe lihet një volum jo më shumë se 10 ml.

n) Mostra e mbetur prej 10 ml hidhet në enën e numërimit të larvave ose pjatë petri.

o) Cilindri apo tubi centrifugës shpëlahet me jo më shumë se 10 ml ujë rubineti, i cili i shtohet mostrës në enën e numërimit të larvave ose pjatën e petrit. Më pas, mostra ekzaminohet me trikinoskop ose stereomikroskop me zmadhim nga 15–20 herë. Teknika të tjera vizuale lejohen të përdoren, për të siguruar kontrollin e mostrave pozitive dhe që japin rezultate të barabarta ose më të mira se metodat vizuale tradicionale. Në të gjitha rastet e zonave të dyshimta, ose formave të ngjashme të parazitëve, pamja zmadhohet 60–100 herë.

p) Tretjet ekzaminohen sa më shpejtë sapo të jenë gati. Në asnjë rrethanë, ekzaminimi nuk shtyhet për ditën tjetër.

Kur tretjet nuk ekzaminohen brenda 30 minutave nga përgatitja, atëherë ato duhen kulluar si më poshtë:

Mostra përfundimtare prej 40 ml hidhet në një cilindër matës ku qëndron për 10 minuta. Largohen 30 ml të lëngut sipërfaqësor duke lënë një volum prej 10 ml. Ky volum çohet deri në 40 ml me ujë rubineti. Pas qëndrimit për një periudhë prej 10 minutash, largohen me kujdes 30 ml nga shtresa sipërfaqësore nëpërmjet thithjes dhe lihet një volum jo më shumë se 10 ml, që do të ekzaminohet në pjatë petri ose enën e numërimit të larvave. Cilindri matës lahet me jo më shumë se 10 ml ujë rubineti dhe lëngjet e larjes i shtohen mostrës në pjatën e petrit ose në enën e numërimit të larvave për ekzaminim.

Në qoftë se në ekzaminim, sedimenti del jo i qartë, atëherë mostra hidhet në cilindrin matës dhe plotësohet deri në 40 ml me ujë rubineti dhe pas kësaj ndiqet procedura e përshkruar në këtë

paragraf. Procedura përsëritet 2–4 herë deri sa lëngu qartësohet mjaftueshëm për lexim të saktë.

II. Sasitë më pak se 100 g

Atëherë kur është e nevojshme, shtohet deri në 15 g në një bashkim të plotë prej 100 g dhe ekzaminohet së bashku me këto mostra sipas paragrafit I.

Më tepër se 15 g duhet të ekzaminohen si një bashkim i plotë. Për bashkime deri në 50 g, lëngu tretës dhe përbërësit mund të reduktohen deri në 1 litër ujë, 8 ml acid klorhidrik dhe 5 g pepsinë.

III. Rezultatet e dyshimta ose pozitive

Kur rezultati i ekzaminimit të një mostre kolektive del pozitive ose jep rezultat të pasigurt, nga çdo derr merret prapë mostër prej 20 g sipas pikës 2(a). Mostrat prej 20 g të marra nga 5 derra bashkohen dhe ekzaminohen me metodën e përshkruar në këtë kre. Në këtë mënyrë ekzaminohen mostrat e marra nga 20 grupe të 5 derrave.

Kur trikinela është zbuluar në një mostër të bashkuar nga pesë derra, merren prapë mostra të tjera prej 20 g nga derra individualë në grup dhe secila mostër ekzaminohet e ndarë nga të tjerat duke përdorur metodën e përshkruar në këtë kre.

Mostrat që dalin me parazit mbahen në alkool etilik 90% për ruajtje dhe identifikohen në nivel specie në një laborator reference.

Pas mbledhjes së parazitëve, lëngjet pozitive (lëngu tretës, lëngu sipërfaqësor, lëngjet larëse etj.) dekontaminohen me nxehtësi deri në 60°C.

IV. Procedura e pastrimit dhe dekontaminimit pas rezultateve pozitive apo të dyshimta

Kur nga ekzaminimi i mostrave kolektive ose individuale dalin rezultate të dyshimta ose pozitive, i gjithë materiali në kontakt me mishin (ena bluarëse dhe thika, bejkeri, thupra përzierëse, sensori i temperaturës, hinka konike filtruese, sita dhe pincat) dekontaminohen me kujdes me larje me ujë të ngrohtë (65–90°C). Rekomandohet shpëlarja e çdo pjese me kujdes për largimin e detergjentit në qoftë se është përdorur detergjent gjatë larjes.

KREU II
METODAT EKUIVALENTE

A. Metoda e tretjes së mostrave të bashkuar mekanikisht/teknika e sedimentimit

1. Pajisje dhe reagjentë

a) Thika apo gërshërë për copëtimin e mostrave.

b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajnë mostrat afërsisht prej 2 g të mishit, apo mjete të tjera, duke dhënë garanci ekuivalente në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.

c) Copëtues mishi ose blender elektrik.

d) Stomacher blender laboratori modeli 3.500 termo.

e) Qese plastike për Stomacher.

f) Hinka ndarëse konike, kapaciteti 2 l, preferohet e mbyllur me tapë sigurie tefloni.

g) Mbajtëse, unaza dhe kapëse.

h) Sita, me madhësi rrjete 180 mikron, diametri i jashtëm 11 cm, inoks.

i) Hinka, diametri i brendshëm jo më pak se 12 cm, për mbajtjen e sitave.

j) Cilindra matës qelqi 100 ml.

k) Termometër me saktësi deri në 0.5°C që mat nga 1 deri në 100°C.

l) Vibrator, p.sh. makinë rroje elektrike që i hiqet koka.

m) Rele që fik dhe ndez në një interval prej 1 minutë.

n) Trikinoskop me tavolinë horizontale ose stereomikroskop, me një nënfazë burimi drite të transmetuar me intensitet të rregullueshëm.

o) Enë për numërimin e larvave dhe një numër pjata petri me diametër 9 cm si në kreun I(1), germa "l" dhe "m".

p) acid klorhidrik 17,5%.

q) Pepsinë, fuqia: 1:10 000 NF (US National Formulary) që i korrespondon 1:12 500 BP (British Pharmacopoeia) dhe 2 000 FIP (Fédération internationale de pharmacie), ose pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimumi 660 European Pharmacopoeia njësi/ml.

r) Bidonë 10 litra që përdoren për dekontaminimin e aparateve, si p.sh., bidonë me formol, si dhe për lëngun tretës që mbetet pas testimit pozitiv të kampioneve.

s) Peshore me saktësi 0,1 g.

2. Mbledhja e kampioneve dhe sasia që do të tretet

Siç përcaktohet në kreun I (2).

3. Procedura

I. Grirja

Grirja më përpara e mostrave të mishit në një grirëse mishi do të përmirësojë cilësinë e tretjes. Në rastet kur përdoret blender elektrik, ai duhet përdorur 3–4 herë, afërsisht një sekondë çdo herë.

II. Procedura e tretjes

Kjo procedurë mund të përfshijë bashkimin e plotë (100 g të mostrave në një kohë) ose bashkimin e më pak se 100 g.

a) Bashkimin e plotë (100 mostra në një kohë)

i) Grirësi laboratorik Stomacher 3500 pajiset me një qese plastike të dyfishtë dhe komplet për kontrollin e temperaturës në 40–41°C.

ii) Një litër e gjysmë ujë i parangrohur në temperaturën 40–41°C futet në qesen plastike të brendshme.

iii) në ujin e Stomacher shtohet 25 ml acid klorhidrik 17.5%.

iv) Shtohen 100 mostra me peshë afërsisht 1 g secila (në 25–30°C) të marra nga çdo mostër individuale në përputhje me pikën 2.

v) Në fund shtohet 6 g pepsinë ose 18 ml pepsinë e lëngshme. Kjo radhë duhet ndjekur me kujdes që të shmanget dekompozimi i pepsinës.

vi) Lihet Stomacher të godasë përmbajtjen e qeses për 25 minuta.

vii) Hiqet qesja plastike nga Stomacher dhe lëngu i tretur filtrohet nëpërmjet sitës në një bejker 3 litra.

viii) Qesja plastike lahet afërsisht me 100 ml ujë, i cili pastaj përdoret për shpëlarjen e sitës dhe së fundmi shtohet në filtratin e bejkerit.

ix) Deri 15 mostra individuale mund të shtohen në një bashkim total të 100 mostrave dhe të ekzaminohen së bashku me këto mostra.

b) Bashkime më të vogla (më pak se 100 mostra):

i) Grirës laboratorik Stomacher 3500 pajiset me qese plastike të dyfishtë dhe komplet për kontrollin e temperaturës në 40–41°C.

ii) lëngu i tretjes përgatitet duke përzierë rreth 1 litër e gjysmë ujë dhe 25 ml acid klorhidrik 17.5%. Shtohet 6 g pepsinë dhe e tëra përzihet në temperaturë 40–41°C.

Kjo radhë duhet ndjekur në mënyrë korrekte që të shmanget dekompozimi i pepsinës.

iii) Nga lëngu tretës, matet një volum që i korrespondon 15 ml për gram të mostrës (p.sh. për 30 mostra volumi i kërkuar është 30x15 ml = 450 ml) dhe transferohet te dy qeset plastike të brendshme së bashku me mostrat e mishit me peshë afërsisht 1 g (në 25–30°C) të marra nga çdo mostër individuale sipas pikës 2.

iv) Në qesen e jashtme hidhet ujë në temperaturë afërsisht 41°C në mënyrë që volumi total në të dy qeset të shkojë 1 litër e gjysmë. Lihet Stomacher të godasë përmbajtjen e qeses për 25 minuta.

v) Qesja plastike hiqet prej Stomacher dhe lëngu tretës filtrohet nëpërmjet sitës në një bejker 3 litra.

vi) Qesja plastike lahet afërsisht me 100 ml ujë (në 25–30°C), i cili pastaj përdoret për të shpëlarë sitën dhe së fundmi shtohet te filtrati i bejkerit.

III. Zbulimi i larvave me sedimentim

a) Copa akulli 300–400 g të thyera në copa më të vogla futen te lëngu tretës për ta rritur volumin në 2 litra. Lëngu tretës tundet deri sa akulli të shkrihet. Në rast se kemi sasi më të vogla bashkimesh (shiko paragrafin II (b)) sasia e akullit duhet të reduktohet në mënyrë korresponduese.

b) Lëngu i ftohët tretës transferohet në hinkë ndarëse 2 litra, të pajisur me një vibrator në një fiksuese ekstra.

c) Sedimentimi lejohet për 30 minuta. Gjatë kësaj kohe hinka sedimentuese vibrohet me ndërprerje, p.sh.1 minutë vibrim pasohet nga 1 minutë pushim.

d) Pas 30 minutash, 60 ml mostër e sedimentit futet shpejt në cilindrin matës 100 ml (hinka shpëlahet me detergjent pas përdorimit).

e) Mostra 60 ml lihet të paktën për 10 minuta, pas kësaj kohe largohet lëngu sipërfaqësor me thithje duke lënë një volum prej 15 ml, i cili ekzaminohet për gjetjen e larvave.

f) Për thithje, përdoret shiringë e pajisur me tub plastik. Gjatësia e tubit duhet të jetë e tillë që 15 ml të mbesë në cilindrin matës kur dorezat e shiringës mbështeten te buzët e cilindrit.

g) Sasia që mbetet prej 15 ml hidhet në enën për numërimin e larvave apo në pjatë petri dhe ekzaminohet me trikinoskop ose stereo-mikroskop.

h) Cilindri matës lahet me 5–10 ml ujë rubineti dhe shpëlarja shtohet në mostër.

i) Lëngjet tretëse duhet të ekzaminohen sapo të jenë gati. Në asnjë mënyrë ekzaminimi nuk duhet të vonohet deri ditën tjetër.

Kur tretësirat pas tretjes janë të paqarta, ose kur nuk ekzaminohen brenda 30 minutave nga përgatitja e tyre, ato qartësohen si më poshtë:

a) mostra përfundimtare prej 60 ml futet në cilindrin matës dhe lihet të qëndrojë për 10 minuta. Pastaj, me thithje largohet 45 ml lëng sipërfaqësor dhe mbeten 15 ml ku shtohet 45 ml ujë rubineti;

b) pas qëndrimit për 10 minuta, 30 ml i lëngut sipërfaqësor largohet me thithje dhe mbesin 15 ml që hidhen në pjatë petri ose në enën për numërimin dhe ekzaminimin e larvave;

c) cilindri matës lahet me 10 ml ujë rubineti dhe ky ujë shtohet te mostra në pjatën e petrit ose në enën për numërimin e larvave për ekzaminim.

II. Rezultatet pozitive dhe të dyshimta

Kur rezultati del pozitiv apo i panjohur zbatohen dispozitat e përcaktuara në kreun I(3)(III).

B. Metoda e tretjes së mostrave të bashkuara të ndihmuara mekanikisht/- Teknika e "izolimit në filtër"

1. Pajisje dhe reagjentë

Siç është përcaktuar në paragrafin A(1).

Pajisje shtesë:

a) Hinkë 1 litërshe gelman me mbajtëse filtri (diametri 45 mm);

b) Disqe filtri, që konsistojnë me rrjetë rrethore inoks me hapje 35 mikron (diametri i diskut 45 mm), dy unaza gome me trashësi 1mm (diametri i jashtëm 45 mm, diametri i brendshëm 38 mm), rrjeta rrethore vendoset ndërmjet dy unazave prej gome dhe ngjitet me ngjitëse të përshtatshme për të dy materialet;

c) Një balonë erlenmajer me kapacitet 3 litra, e pajisur me tub për thithje;

d) Pompë filtri;

e) Qese plastike, kapaciteti të paktën 80 ml;

f) Pajisje për vulosjen e qeseve plastike;

g) Renilaza, me fuqi 1:150 000 njësi Sokslet për gram.

2. *Mbledhja e mostrave*

Sipas përcaktimit në kreun I(2).

3. Procedura

I. Grirja

Mostrat e mishit grihen që të përmirësohet tretja e tyre. Në rast se përdoret blender elektrik, ky i fundit duhet të përdoret 3–4 herë përafërsisht 1 sekondë çdo herë.

II. Procedura e tretjes

Kjo procedurë mund të përfshijë të gjithë bashkimet (100 g mostra në të njëjtën kohë) ose bashkime më pak se 100 g.

a) Bashkimet e plota (100 mostra në të njëjtën kohë).

Sipas paragrafit A(3)(II)(a).

b) Bashkime më të vogla (më pak se 100 mostra).

Sipas paragrafit A(3)(II)(b).

III. Rigjenerimi i larvave me filtrim

a) Akull (300 deri 400 g copa akulli) shtohet në lëngun tretës që volumi të shkojë deri në 2 litra. Në rast se bashkimi që do të analizohet është më i vogël, atëherë ulet sasia e akullit në mënyrë korresponduese.

b) Lëngu tretës përzihet deri sa të shkrihet akulli. Lëngu tretës i ftohur lihet të paktën për 3 minuta në mënyrë që larvat të rrotullohen në vetvete.

c) Hinka gelman, e pajisur me mbajtëse filtri dhe disk filtri, montohet në balonën erlenmajer të lidhur me pompë filtri.

d) Lëngu tretës hidhet në hinkën gelman dhe filtrohet. Me mbarimin e filtrimit, lëngu tretës ndihmohet të kalojë në filtër duke e thithur me pompën e filtrit. Thithja mund të ndalojë para se të thahet filtri, p.sh., kur ka ngelur 2–5 ml lëng në hinkë.

e) Kur i gjithë lëngu tretës është filtruar, disku i filtrit hiqet dhe vendoset në një qese plastike me kapacitet 80 ml së bashku me 15–20 ml tretësirë renilazë. Tretësira e renilazës përgatitet duke shtuar 2 g renilazë në 100 ml ujë rubineti.

f) Qesja plastike vuloset dy herë dhe vendoset ndërmjet qeses së brendshme dhe të jashtme në Stomacher.

g) Stomacher tundet për 3 minuta.

h) Pas 3 minutash, qesja plastike së bashku me diskun e filtrit dhe tretësirën e renilazës hiqet nga Stomacher dhe hapet me gërshërë. Lëngu që përmban hidhet në enën për numërimin e larvave ose në pjatë petri. Qesja lahet me 5–10 ml ujë, i cili pastaj shtohet në enën për numërimin e larvave për ekzaminim në trikinoskop ose pjatë petri për ekzaminim me stereomikroskop.

i) Lëngjet tretëse duhet të ekzaminohen sapo të jenë gati. Në asnjë mënyrë ekzaminimi nuk duhet të vonohet deri ditën tjetër.

Shënim. Disqet e filtrave të mos përdoren asnjëherë pa u pastruar plotësisht. Disqet e papastra nuk duhet të thahen asnjëherë. Disqet e filtrave mund të pastrohen duke i lënë gjithë natën në tretësirë renilaze. Përpara përdorimit ato duhet të lahen me tretësirë renilaze të freskët duke përdorur Stomacher-in.

IV. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Kur rezultati del pozitiv ose i dyshimtë zbatohen dispozitat e përcaktuara në kreun I(3)(III).

C. Metoda e tretjes automatike për mostrat e bashkuara deri në 35 g

1. Pajisje dhe reagjentë

a) Thikë ose gërshërë për prerjen e mostrave.

b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajnë mostrat afërsisht prej 2 g të mishit, apo mjete të tjera, duke dhënë garanci ekuivalente në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.

c) Blender 35® që përbëhet nga tri ngjyra, i pajisur me filtër.

d) Acid klorhidrik 8,5 ± 0,5 % në peshë.

e) Membranë filtrash polikarbonate transparente me diametër 50 mm dhe me madhësi poresh 14 mikron.

f) Pepsinë me fuqi 1:10 000 NF (US National Formulary) që i korrespondon 1:12 500 BP (British Pharmacopoeia), si dhe 2 000 FIP (Fédération internationale de pharmacie) ose pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimum 660 European Pharmacopoeia njësi për 1 ml.

g) Peshore me saktësi deri në 0,1 g.

h) Pincetë me majë të sheshtë.

i) Disa pjata mikroskopi me gjatësi të paktën 5 cm, si dhe disa pjata petri me diametër të paktën 6 cm, të shënuara në anën e poshtme me hapësira 10 x10 mm^2 duke përdorur një instrument me majë.

j) Stereomikroskop me dritë të transmetuar (me zmadhim 15–60 herë) ose trikinoskop me tavolinë horizontale.

k) Enë për hedhjen e mbetjeve të lëngshme.

l) Enë ose bidonë 10 litërsh që përdoren për dekontaminimin e aparatit, p.sh., me formol, si dhe për lëngjet tretëse që mbesin kur mostrat dalin pozitiv.

m) Termometër me saktësi 0.5°C, që mat nga 1 deri në 10°C.

2. Mbledhja e mostrave

Sipas përcaktimit në kreun I(2).

3.Procedura

I. Procedura me tretje

a) Vendoset blenderi me filtrin e shtuar, lidhet tubi i mbetjeve dhe tubi vendoset në mënyrë të tillë që të rrjedhë në enën e mbeturinave.

b) Kur blenderi lidhet me energjinë elektrike, nis nxehja.

c) Përpara se të bëhet kjo, valvola në pjesën e poshtme e vendosur poshtë dhomës së reaksionit duhet të hapet dhe të mbyllet.

d) Shtohen deri në 35 mostra që peshojnë afërsisht 1 g secila (në 25–30°C) të marra nga çdo mostër individuale në përputhje me pikën 2. Të sigurohet që pjesët më të mëdha të tendinave janë hequr pasi ato mund të bllokojnë filtrin.

e) Hidhet ujë deri në shenjë në një dhomë lëngjesh të lidhur me blenderin (afërsisht 400 ml).

f) Shtohen rreth 30 ml acid klorhidrik (8.5%) nga ana më e vogël, e lidhur me dhomën e lëngjeve.

g) Vendoset membrana e filtrit nën filtrin e trashë në mbajtësen e filtrit të filtrit të shtuar.

h) Në fund, shtohen 7 g pepsinë ose 21 ml pepsinë e lëngshme. Kjo radhë duhet ndjekur me kujdes që të shmanget dekompozimi i pepsinës.

i) Mbyllen kapakët e dhomave të reaksionit dhe dhomave të lëngshme.

j) Zgjidhet periudha e tretjes. Një periudhë e shkurtër tretjeje (5 minuta) mund të zgjidhet për mostrat që merren te derrat që janë në moshë normale therjeje, dhe kohë më e gjatë (8 minuta) për mostrat e tjera.

k) Kur ndizet butoni i nisjes së punës së blenderit, procesi i shpërndarjes dhe i tretjes fillon automatikisht, dhe pasohet me filtrimin. Pas 10–13 minutash procesi përfundon dhe ndalon automatikisht.

l) Kapaku i dhomës së reaksioneve hapet vetëm pasi sigurohemi që dhoma është bosh. Në qoftë se ka shkumë ose ka mbetur lëng tretës në dhomë procedura përsëritet sipas paragrafit V.

II. Rigjenerimi i larvave

a) Hiqet mbajtësja e filtrit dhe transferohet membrana filtruese me një mbajtëse të pjerrët ose pjatë petri.

b) Shqyrtohet 22847 embrane filtruese e përdorur në një stereomikroskop ose një trikinoskop.

III. Pajisjet e pastrimit

a) Kur rezultati del pozitiv, dhoma e reaksionit të blenderit mbushet me ujë të valuar deri në 2/3 e saj. Pastaj hidhet ujë i zakonshëm rubineti në dhomën e lidhur të lëngjeve derisa të mbulohet sensori më i poshtëm. Pastrimi bëhet në mënyrë automatike. Dekontaminimi i mbajtësit të filtrit dhe çdo pajisje tjetër bëhet duke përdorur formol.

b) Pas përfundimit të ditës së punës, mbushet dhoma e lëngjeve të blenderit me ujë dhe vendoset në ciklin standard.

IV. Përdorimi i membranës filtruese

Çdo membranë filtri polikarbonate mund të përdoret jo më shumë se 5 herë. Filtri duhet të kthehet pas çdo përdorimi. Për më tepër, filtri duhet të kontrollohet pas çdo përdorimi për ndonjë dëmtim, i cili mund ta bëjë të papërshtatshëm për përdorim të mëtejshëm.

V. Metoda që përdoret kur tretja nuk është e plotë dhe nuk mund të bëhet filtrimi.

Sapo blenderi vendoset në ciklin automatik sipas paragrafit I, hapet kapaku i dhomës së reaksionit dhe kontrollohet nëse ka shkumë ose lëng tjetër të mbetur në dhomë. Në qoftë se ka të tilla, veprohet si më poshtë:

a) Mbyllet valvola e poshtme poshtë dhomës së reaksionit;

b) Largohet mbajtësja e filtrit dhe vendoset membrana filtruese në një pjatë mikroskopi ose pjatë petri.

c) Vendoset një membranë e re filtruese te mbajtësi i filtrit dhe montohet mbajtësja e filtrit;

d) Mbushet dhoma e lëngjeve të blenderit me ujë derisa sensori i poshtëm të mbulohet;

e) Kryhet cikli automatik i pastrimit;

f) Pasi cikli i pastrimit ka mbaruar, hapet kapaku i dhomës së reaksionit dhe kontrollohet për mbetje lëngjesh;

g) Kur dhoma është bosh, hiqet mbajtësja e filtrit dhe vendoset membrana e filtrit te një pjatë mikroskopi ose pjatë petri me anë të pincetës.

h) Ekzaminohen dy membranat e filtrave sipas paragrafit II. Në qoftë se filtrati nuk mund të ekzaminohet, përsëritet i gjithë procesi i tretjes me kohë tretje më të gjatë në përputhje me paragrafin I.

VI. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Kur rezultati del pozitiv ose i dyshimtë zbatohen dispozitat e përcaktuara në kreun I(3)(III).

D. Metoda me përzierje magnetike për tretjen e kampioneve / "izolimi në filtër" dhe zbulimi i larvave me testin e ngjitjes me qumësht

Kjo metodë është konsideruar e barasvlershme vetëm për testimin e mishit të derrave shtëpiakë.

1. Pajisje dhe reagjentë

a) Thikë ose gërshërë dhe pinceta për copëtimin e mostrave.

b) Tabaka e ndarë në 50 kuadrate, ku secila prej tyre mund të mbajë mostrat afërsisht prej 2 g të mishit, apo mjete të tjera, duke dhënë garanci ekuivalente në lidhje me gjurmueshmërinë e mostrave.

c) Blender me thikë copëtuese. Kur mostrat janë më të mëdha se 3 g, përdoret copëtues mishi me hapje 2–4 mm ose gërshërë. Në rast se mishi është i ngrirë apo është gjuhë (pas largimit të shtresës sipërfaqësore, e cila nuk mund të tretet) përdorimi i copëtuesit të mishit është i domosdoshëm dhe madhësia e mostrave rritet në mënyrë të konsiderueshme.

d) Përzierës magnetik me pjatë ngrohje të kontrolluar në mënyrë termostatike dhe thupër për përzierje të veshur me teflon afërsisht 5 cm i gjatë.

e) Bejkera qelqi, kapaciteti 3 litra.

f) Sita, madhësia e rrjetës 180 mikron, diametri i jashtëm 11 cm, me rrjetë inoksi.

g) Aparat filtrimi prej çeliku për rrjeta filtri 20 µm me hinkë çeliku.

h) Pompë vakumi.

i) Enë metali ose plastike, me kapacitete 10–15 litra, për të mbledhur lëngun tretës.

j) Një rrotullues 3D.

k) Fletë alumini.

l) Acid klorhidrik 25%.

m) Pepsinë me fuqi 1:10 000 NF (US National Formulary) që i korrespondon 1:12 500 BP (British Pharmacopoeia), si dhe 2 000 FIP (Fédération internationale de pharmacie) ose pepsinë e lëngshme e stabilizuar me minimumi 660 European Pharmacopoeia njësi/ml.

n) Ujë rubineti i nxehtë në 46–48°C.

o) Peshore me saktësi 0.1 g.

p) Pipeta të madhësive të ndryshme (1, 10 dhe

25 ml), mikropipeta sipas instruksioneve të prodhuesit të ngjitësit të lateksit, si dhe mbajtëse pipetash.

q) Filtra me rrjetë najloni 20 mikron me diametër që përputhet me sistemin e filtrimit.

r) Pinceta plastike ose çeliku nga 10–15 cm.

s) Shishe konike, 15 ml.

t) Shtypës havani me majë konike tefloni ose çeliku për t'u përshtatur me shishen konike.

u) Termometër me saktësi 0.5°C, që mat nga 1-100 °C.

v) Letra ngjitëse lateksi të testit me kit Trichin-L Antigen të validuar me kod No EURLP_D_001/2011.

w) Tretësirë asnjanëse (buffer) me konservantë (mostër tretësi) për testin me kit Trichin-L me kod No EURLP_D_001/2011.

x) Tretësirë asnjanëse (buffer) të shtuar me konservantë (kontrolli negativ) të testit me kit Trichin-L antigen me kod No EURLP_D_001/2011.

y) Tretësirë asnjanëse (buffer) të shtuar me antigjenet e Trichinella spiralis dhe konservantë (kontrolli pozitiv) i testit me kit Trichin-L antigen me kod No EURLP_D_001/2011.

z) Tretësirë asnjanëse (buffer) të veshur me copëza polistireni të shtuar me antitrupa me konservantë (rruaza lateksi) të testit me kit me antigen të Trichin-L me kod No EURLP_D_001/2011

aa) Kunja njëpërdorimshme.

2. *Mbledhja e mostrave*

Sipas përcaktimit në kreun I(2).

3. Procedura

I. Për bashkime të plota (100 g mostra në të njëjtën kohë)

a) 16 ± 0,5 ml acid kloridrik 25% (0,2% finale) hidhet në një bejker 3 litra që përmban 2.0 litra ± 200 ml ujë rubineti, të nxehur më parë në 46–48°C; thupra përzierëse vendoset në bejker dhe bejkeri vendoset në pjatën e parangrohur dhe fillon përzierja.

b) Shtohet 10 ± 1 g pepsinë pudër (ose 30 ± 3 ml pepsinë e lëngshme).

c) 100–115 g mostra të mbledhura sipas pikës 2 copëtohen në blender bashkë me 150 ± 15 ml tretësirë asnjanëse (buffer) të ngrohur më parë.

d) Mishi i copëtuar transferohet në një bejker 3 litra që përmban ujë, pepsinë dhe acid klorhidrik.

e) Thika e copëtuesit zhytet herë pas here në lëngun tretës në bejker dhe ena e copëtuesit shpëlahet me sasi të vogla të lëngut tretës për të larguar çdo sasi mishi që mund të jetë ngjitur.

f) Bejkeri mbulohet me fletë alumini.

g) Përzierësi magnetik duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që të mbajë një temperaturë konstante 44–46°C gjatë gjithë veprimit. Gjatë përzierjes, lëngu tretës duhet të rrotullohet me shpejtësi të lartë të mjaftueshme për të krijuar një fugë të thellë, por pa spërkatur.

h) Lëngu tretës përzihet derisa grimcat e mishit zhduken (afërsisht 30 minuta). Përzierja ndërpritet dhe lëngu tretës hidhet nëpërmjet sitës në hinkën e sedimentimit. Tretja mund të kërkojë kohë të gjatë (jo më shumë se 60 minuta) në përpunimin e disa llojeve të mishit (gjuhë, mish gjahu etj.).

i) Procesi i tretjes konsiderohet i kënaqshëm në qoftë se jo më shumë se 5% e peshës së mostrës fillestare mbetet në sitë.

j) Filtri 20 mikron prej najloni vendoset në mbajtësen e filtrit. Hinka konike prej çeliku fiksohet te mbajtësja me sistem bllokimi dhe rrjeta prej çeliku me madhësi 180 mikron vendoset në hinkë. Pompa e vakumit lidhet me mbështetësen e filtrit dhe me enën prej metali apo plastike, për të mbledhur lëngun tretës.

k) Përzierja ndalohet dhe lëngu tretës hidhet në hinkën e filtrimit nëpërmjet rrjetës. Bejkeri shpëlahet afërsisht me 250 ml ujë të ngrohtë. Uji i shpëlarjes hidhet të filtrohet pasi të jetë filtruar plotësisht lëngu tretës.

l) Membrana e filtrimit kapet me pincetë duke e mbajtur nga anët. Kjo membranë paloset në katërsh (minimumi) dhe futet në tubin konik 15 ml. Zgjedhja e tubit konik duhet t'i përshtatet shtypësit të havanit.

m) Membrana e filtrimit shtyhet në fund të tubit konik 15 ml me ndihmën e shtypësit të havanit dhe shtypet fort afërsisht me 20 lëvizje shtypëse lart e poshtë me shtypësin e havanit, i cili duhet të pozicionohet brenda membranës filtruese, sipas instruksioneve të fabrikuesit.

n) 0,5 ± 0,01 ml nga tretësi i mostrës shtohet në tubin konik me pipetë dhe membrana filtruese homogjenizohet me shtypësin e havanit me lëvizje lart e poshtë për 30 sekonda, duke shmangur lëvizjet që shkaktojnë spërkatje, sipas instruksioneve të fabrikuesit.

o) Çdo mostër, kontrolli negativ dhe kontrolli pozitiv shpërndahen në fusha të ndryshme të letrës ngjitëse me pipeta, sipas instruksioneve të fabrikuesit.

p) Rruazat e lateksit hidhen në çdo fushë të letrës ngjitëse me pipetë, sipas instruksioneve të fabrikuesit, pa i lejuar që të vijnë në kontakt me mostrën/mostrat dhe me kontrollet. Në çdo fushë, rruazat e lateksit përzihen me kujdes me një thupër të përshtatshme deri sa lëngu i homogjenizuar të mbulojë të gjithë fushën.

q) Letra ngjitëse vendoset në tundësin 3D dhe tundet për 10 ± 1 minuta, sipas instruksioneve të fabrikuesit.

r) Pas kohës së llogaritur në instruksionet e fabrikuesit, tundja ndalohet dhe letra ngjitëse vendoset në një sipërfaqe të sheshtë dhe rezultatet e reaksionit lexohen menjëherë, sipas instruksioneve të fabrikuesit. Rruazat e bashkuara shfaqen në rastet kur kemi një mostër pozitive. Në rast të mostrave negative, gjendja e turbullt mbetet homogjene, pa rruaza të bashkuara.

II. Për bashkime më të vogla se 100 g, siç është përcaktuar në kreun I(3)(II).

Për bashkimet më të vogla se 100 g do të ndiqet procedura e dhënë në kreun I(3)(II).

III. Rezultatet pozitive ose të dyshimta

Kur ekzaminimi i një mostre kolektive jep rezultat pozitiv ose të dyshimtë në testin e ngjitjes së lateksit, atëherë nga çdo derr merren mostra të tjera me nga 20 g, në përputhje me kreun I(2)(a). Mostrat prej 20 g nga pesë derra bashkohen dhe ekzaminohen duke përdorur metodën e përshkruar në paragrafin I. Në këtë mënyrë mund të ekzaminohen mostrat nga 20 grupe të pesë derrave.

Kur merret një rezultat pozitiv nga bashkimi i lateksit nga një grup i pesë derrave, mostra të tjera 20 g secila merren nga individët në grup dhe secili ekzaminohet i ndarë duke përdorur metodën e përshkruar në kreun I.

Kur merret një rezultat pozitiv ose i dyshimtë nga bashkimi i lateksit, të paktën 20 g nga muskujt e derrit dërgohet në laboratorin e referencës për konfirmin sipas kreut I.

Mostrat me parazit ruhen në alkool etilik 90% dhe identifikohen në nivel specie në laboratorin kombëtar të referencës.

Pas mbledhjes së parazitëve, lëngjet pozitive duhet të dekontaminohen me nxehtësi të pakën në 60°C.

IV. Procedura e pastrimit dhe dekontaminimit pas rezultateve pozitive apo të dyshimta

Kur nga ekzaminimi i një mostre kolektive apo individuale në testin e bashkimi të lateksit, dalin rezultate pozitive ose të dyshimta, i gjithë materiali në kontakt me mishin (blender, thika, shtypësi i havanit, bejkeri, thupra përzierëse, sensori i temperaturës, hinka konike e filtrimit, sita dhe pincetat) duhet të dekontaminohen me kujdes duke i zhytur për disa sekonda në ujë të nxehtë (65–90°C). Mbetjet e mishit ose larvat e pa aktivizuara që mund të mbesin në sipërfaqen e tyre duhet të largohen me sfungjer të pastër dhe me ujë rubineti. Nëse kërkohet, disa pika detergjent mund të shtohen për të larguar yndyrën nga pajisjet. Rekomandohet shpëlarja e çdo pjese plotësisht për të hequr të gjitha gjurmët e detergjentit.

E. Testi i tretjes artificiale për zbulimin in vitro të larvave të Trichinella spp. në mostrat e mishit PrioCHECK® Trichinella AAD Kit

Kjo metodë është konsideruar e barasvlershme vetëm për testimin e mishit të derrave shtëpiakë.

Ky test me Kit PrioCHECK® Trichinella AAD Kit duhet të përdoret sipas manualit të instruksioneve duke përdorur hinka të ndara (Lenz NS 29/32) dhe tub testi qelqi 80 ml.

SHTOJCA II
TRAJTIMET ME NGRIRJE

A. Metoda me ngrirje 1

a) Mishi i sjellë në gjendje të ngrirë duhet të ruhet në këto kushte.

b) Pajisjet teknike, si dhe furnizuesi me energji i dhomës së frigoriferit duhet të jenë të tilla që temperatura e kërkuar të arrihet shpejt dhe të mbahet në të gjitha pjesët e dhomës dhe të mishit.

c) Ambalazhet e izoluara hiqen përpara ngrirjes, me përjashtim të rasteve kur mishi është në temperaturën e kërkuar në momentin që është sjellë në dhomën frigoriferike, si dhe në rastet kur paketimi nuk e pengon mishin të arrijë temperaturën e kërkuar brenda kohës së duhur.

d) Ngarkesat në dhomën frigoriferike duhet të mbahen të ndara veç dhe të mbyllura me çelës.

e) Regjistrohet koha dhe data kur janë futur ngarkesat në dhomën frigoriferike.

f) Temperatura në dhomën frigoriferike duhet të jetë të paktën -25°C. Kjo temperaturë matet duke përdorur instrumente të kalibruara termoelektrike dhe regjistrohet vazhdimisht. Temperatura nuk duhet të matet direkt në ajër të ftohtë. Instrumentet duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhëna nga regjistri i inspektimit të mishit të importit, si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.

g) Mishi me diametër ose trashësi deri në 25 cm duhet të ngrijë për të paktën 240 orë pa ndërprerje, ndërsa mishi me diametër ose trashësi nga 25 cm deri në 50 cm duhet ngrijë për të paktën 480 orë pa ndërprerje. Procesi i ngrirjes nuk duhet të aplikohet për mish me trashësi ose diametër më të madh. Koha e ngrirjes llogaritet duke u nisur nga pika kur temperatura në dhomën e ngrirjes arrin atë të specifikuar në germën "f".

B. Metoda me ngrirje 2

Dispozitat e përgjithshme dhënë në germat "a" deri "e", të paragrafit A (metoda 1) zbatohen edhe në këtë rast. Kombinimi kohë-temperaturë aplikohet si më poshtë:

a) mishi me diametër ose trashësi deri në 15 cm duhet të ngrijë sipas një nga kombinimet kohë-temperaturë të mëposhtme:

i) 20 ditë në -15°C;
ii) 10 ditë në -23°C;
iii) 6 ditë në -29°C.

b) mishi me diametër ose trashësi ndërmjet 15 cm dhe 50 cm duhet të ngrijë sipas një nga kombinimet kohë-temperaturë të mëposhtme:

i) 30 ditë në -15°C;
ii) 20 ditë në -25°C;
iii) 12 ditë në -29°C.

Temperatura në dhomën e ngrirjes nuk duhet të jetë më e madhe se niveli i temperaturës së inaktivimit të zgjedhur. Kjo temperaturë matet duke përdorur instrumente të kalibruara termoelektrike dhe regjistrohet vazhdimisht. Temperatura nuk duhet të matet direkt në ajër të ftohtë. Instrumentet duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhëna nga regjistri i inspektimit të mishit të importit, si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.

C. Metoda me ngrirje 3

Trajtimi konsiston në ngrirje–tharje ose ngrirje të mishit për kombinimin e specifikuar kohë-temperaturë me temperaturë të monitoruar në qendër të secilës copë.

a) Dispozitat e përgjithshme dhënë në germat "a" deri "e" të paragrafit A (metoda 1) zbatohen edhe në këtë rast dhe aplikohet kombinimi kohë-temperaturë, si më poshtë:

i) 106 orë në -18°C;
ii) 82 orë në -21°C;
iii) 63 orë në -23,5°C;
iv) 48 orë në -26°C;
v) 35 orë në -29°C;
vi) 22 orë në -32°C;
vii) 8 orë në -35°C;
viii) 1/2 orë në -37°C.

Temperatura matet duke përdorur instrumente termoelektrike të kalibruara dhe regjistrohet vazhdimisht. Termometri futet në qendër të copës së prerë të mishit e cila nuk duhet të jetë më e vogël se pjesa më trashë e mishit që duhet të futet në ngrirje. Kjo copë futet në dhomën e ngrirjes në një pozicion të përshtatshëm, jo ngjitur me pajisjet e ftohjes apo direkt në rrymën e ftohtë të ajrit. Instrumentat duhet të mbahen të mbyllura me çelës. Grafikët e temperaturës duhet të mbajnë të dhëna nga regjistri i inspektimit të mishit të importit, si dhe datën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të ngrirjes së mishit. Këto të dhëna të ruhen për 1 vit pas plotësimit.

SHTOJCA III
EKZAMINIMI I KAFSHËVE TË TJERA NGA DERRI

Mishi i kalit, mishi i kafshëve të egra dhe çdo mish tjetër që mund të përmbajnë parazitët Trichinella duhet të shqyrtohet në përputhje me një nga metodat e tretjes të përcaktuara në kreun I ose II të shtojcës I, me ndryshimet e mëposhtme:

a) Mostra me peshë të paktën 10 g merren nga gjuha ose muskujt e nofullës së kuajve dhe nga këmbët e përparme, gjuha ose diafragma e derrit të egër;

b) Në rastin e kuajve, ku këto muskuj mungojnë, një mostër me madhësi më të madhe merret nga një shtyllë e diafragmës në kalimin për në pjesën e forcuar. Muskujt duhet të pastrohen nga indet lidhëse dhe yndyra;

c) Të paktën 5 g mostër tretet duke ndjekur metodën referencë të zbulimit të përcaktuar në kreun I ose një metodë ekuivalente të përcaktuar në kreun II. Për çdo tretje, pesha totale e muskujve të ekzaminuar nuk duhet të kalojë 100 g në rastin e metodës së përcaktuar në kreun I dhe metodat A dhe B të përcaktuara në kreun II, si dhe 35 g në rastin e metodës C të përcaktuar në kreun II;

d) Kur rezultati është pozitiv, merret një mostër tjetër 50 g për një ekzaminim të mëvonshëm të pavarur;

e) Pa cenuar rregullat për ruajtjen e specieve të kafshëve, i gjithë mishi të kafshëve të egra të tjera nga derri i egër, të tilla si arinj, gjitarët mishngrënës (përfshirë gjitarët e detit) dhe zvarranikët, testohen duke marrë mostra 10 g të muskujve në vendet e preferuara ose sasi më të mëdha në qoftë se këto nuk janë të vlefshme. Vendet e preferuara, janë:

i) tek arinjtë: diafragma, muskujt e nofullës dhe gjuha;

ii) te lopët e detit: gjuha;

iii) te krokodilët: muskujt e nofullës dhe muskujt e brinjëve;

iv) te zogjtë: muskujt e kokës (p.sh., muskujt e nofullës dhe muskujt e qafës);

f) Koha e tretjes duhet të mjaftojë për të siguruar tretjen e duhur të indeve të këtyre kafshëve, por nuk duhet të kalojë 60 minuta.

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 11909/1, datë 18.10.2016

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE MINISTRIT TË FINANCAVE NR. 33, DATË 29.12.2014, "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË DHE NOTERISË"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 33, datë 29.12.2014, "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë", bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë vijon:

a) Kudo në përmbajtjen e udhëzimit pas togfjalëshit "Ministrisë së Drejtësisë" shtohet togfjalëshi "Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor".

b) Pika 2 e shtojcës nr. 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për lëshimin nga gjykata dhe Arkivi Shtetëror të Sistemit Gjyqësor të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani

VENDIM
Nr. 62, datë 4.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo anëtar i " "
Sokol Berberi anëtar i " "
Vitore Tusha anëtare e " "
Altina Xhoxhaj anëtare e " "
Fatmir Hoxha anëtar i " "
Gani Dizdari anëtar i " "
Fatos Lulo anëtar i " "
Besnik Imeraj anëtar i " "

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.6.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Lartë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 2, të nenit 80, të Kodit të Procedurës Penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar për gjykim çështjen penale me të pandehur shtetasit Tom Gjek Doshi, Mark Preng Frroku dhe Durim Dylaver Bami, të akuzuar për veprën penale "Kallëzim i rremë", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 305 dhe 25 të Kodit Penal. Bazuar në nenet 75/b/2, 79/1/a dhe 80/2 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), duke pasur parasysh se të pandehurit Tom Doshi dhe Mark Frroku janë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar Gjykatës së Lartë për gjykimin e procedimit penal nr. 01/2015.

2. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje Gjykata e Lartë ka konstatuar se nga tre të pandehurit vetëm i pandehuri Tom Doshi është deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa dy të pandehurit e tjerë nuk e kanë këtë cilësi. Sipas përfaqësuesve të palëve çështja mund të ndahet, në zbatim të nenit 93/2 të KPP-së, sepse Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar vetëm për të pandehurin deputet, kurse dy të akuzuarit e tjerë të gjykohen nga gjykata e shkallës së parë. Ndërkohë Prokuroria e Përgjithshme është shprehur në gjykim se në rastin konkret duhet të zbatohet neni 80/2 i KPP-së që rregullon rastet e bashkimit të procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme dhe se për shkak të elementit bashkëpunim çështja nuk mund të ndahet, por duhej që të tre të pandehurit të gjykohen nga Gjykata e Lartë si shkallë e parë.

3. Gjykata e Lartë (*gjykata referuese*), duke vlerësuar se pika 2 e nenit 80 të KKP-së është e papajtueshme me Kushtetutën, me vendimin e datës 21.12.2015 ka pezulluar gjykimin e çështjes dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës.

II

4. ***Gjykata referuese*** pretendon se përmbajtja e pikës 2, të nenit 80, të KPP-së është e papajtueshme me Kushtetutën, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

4.1 Neni 80/2 i KPP-së përbën pengesë për realizimin e një procesi të rregullt ligjor për të pandehurit që nuk janë deputetë, për shkak të kufizimit të së drejtës së tyre të ankimit në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe qëllimi e parashikuar nga nenet 17, 43 dhe 141/1 të Kushtetutës. Kjo dispozitë vjen në kundërshtim edhe me nenin 6/1 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të Protokollit nr. 7 të kësaj Konvente.

4.2 Nga mënyra se si është formuluar, neni 80/2 i KPP-së kufizon në mënyrë antikushtetuese të drejtën e gjykatës që nëse veçimi i çështjes është i nevojshëm për mbrojtjen e garancive bazë kushtetuese të të pandehurve që nuk kanë cilësitë e parashikuara në nenin 141/1 të Kushtetutës, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe për respektimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimit që zgjidh çështjen në themel, të mund të vendosë, qoftë kryesisht apo me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim, veçimin e çështjeve. Qëllimet për të cilat është miratuar kjo dispozitë nuk mund të realizohen pa cenuar parashikimet kushtetuese që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, veçanërisht të së drejtës së tyre për të "ushtruar ankim në një gjykatë më të lartë" dhe paralelisht së drejtës për t'u gjykuar nga "një gjykatë e caktuar me ligj".

4.3 Juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë është përjashtim i përcaktuar nga Kushtetuta, bazuar vetëm në cilësinë e subjektit të pandehur, ndërkohë që neni 80/2 i KPP-së bëhet shkak për shtrirjen e juridiksionit fillestar edhe tej subjekteve që parashikon shprehimisht Kushtetuta. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente apo nga një gjykatë, kompetenca e së cilës është përcaktuar në një dispozitë ligjore që në thelb cenon të drejtën e

ankimit, të sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, dhe del tej parashikimeve të përcaktuara në nenin 141/1 të Kushtetutës, ka të bëjë në thelb me mosrespektimin e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga "një gjykatë e caktuar me ligj".

4.4 Në rastet kur Gjykata e Lartë shqyrton akuzat penale ndaj subjekteve të parashikuara në nenin 141/1 të Kushtetutës, vendimi i saj është përfundimtar, i formës së prerë dhe i paankimueshëm për çështje fakti ose ligji në një gjykatë më të lartë të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Ky kufizim ndaj këtyre subjekteve bazohet shprehimisht në nenet 43 dhe 141/1 të Kushtetutës dhe nenin 2 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Kompetenca e Gjykatës së Lartë për gjykimin si shkallë e parë dhe e fundit e akuzave penale ndaj deputetëve, është një kompetencë kushtetuese që nuk mund të zgjerohet apo ngushtohet me ligj, ndaj neni 80/2 i KPP-së është jokushtetues për pjesën që zgjeron një kompetencë të mirëpërcaktuar kushtetuese të Gjykatës së Lartë, duke mos pasur një autorizim të shprehur kushtetues për ta bërë këtë, e duke sjellë për pasojë kufizimin e së drejtës së ankimit dhe atë të gjykimit nga një "gjykatë e caktuar me ligj" për subjektet që nuk përfshihen shprehimisht në nenin 141/1 të Kushtetutës.

4.5 Neni 80/2 i KPP-së përcakton se "gjykata e caktuar me ligj" ndaj subjekteve që nuk përfshihen në nenin 141/1 të Kushtetutës, është Gjykata e Lartë, duke u cenuar atyre të drejtën e ankimit, që sipas nenit 43 të Kushtetutës mund të kufizohet vetëm nëse në Kushtetutë do të parashikohej shprehimisht ndryshe.

5. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

5.1 Nga një interpretim literal dhe teleologjik që i bëhet nenit 80/2 të KPP-së, në korrelacion edhe me nenin 93/1 të KPP-së, rezulton se ai lejon zgjerimin e kompetencës së gjykimit të juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë tej subjekteve të parashikuara nga neni 141/1 i Kushtetutës, vetëm në rastet kur kjo Gjykatë, e ndodhur para procedimeve të lidhura ndërmjet tyre, nuk mund t'i ndajë ato, pasi kjo do të dëmtonte vërtetimin e fakteve, i cili përbën njërin prej dy objekteve të procesit të gjykimit, që janë vërtetimi i fakteve dhe zbatimi i së drejtës/ligjit. Për pasojë, pretendimi për jokushtetutshmërinë e nenit 80/2 të KPP-së duhet parë në korrelacion dhe balancë me ushtrimin e funksionit kushtetues të Gjykatës së Lartë si gjykatë e juridiksionit fillestar ndaj subjekteve që janë parashikuar nga neni 141/1 i Kushtetutës.

5.2 Pretendimi për cenim të elementit të procesit të rregullt ligjor "gjykatë e caktuar me ligj" nuk është i bazuar, sepse vetë neni 42 i Kushtetutës ia ka nënshtruar rezervës ligjore absolute, pra ligjit të miratuar nga Kuvendi, si krijimin, ashtu edhe përcaktimin e kompetencës së gjykatave për të gjykuar një çështje të caktuar, dhe është ligji, në rastin konkret neni 80/2 i KPP-së, që ka parashikuar në këto raste kompetencën e Gjykatës së Lartë.

5.3 Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit, edhe pse kjo e drejtë u kufizohet subjekteve të tjera nga ato që parashikohen nga neni 141/1 i Kushtetutës, ky kufizim është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga neni 17 i Kushtetutës. Ky kufizim jo vetëm nga pikëpamja formale është bërë me ligj, por edhe është vendosur në mbrojtje të interesit publik që do t'i mundësojë Gjykatës së Lartë ushtrimin efektiv të funksionit të saj kushtetues si gjykatë e juridiksionit fillestar ndaj subjekteve të parashikuara nga neni 141/1 i Kushtetutës. Rrjedhimisht, qëllimi që synon dispozita e kundërshtuar është i ligjshëm. Gjithashtu, kufizimi është proporcional, sepse është vendosur vetëm ndaj atyre subjekteve, procedimet penale ndaj të cilave janë të lidhura dhe nuk mund të ndahen, dhe nuk tejkalon as kufizimet e vendosura nga KEDNJ-ja.

5.4 Përveç mjetit të rishikimit të vendimit penal të parashikuar nga nenet 229-457 të KPP-së, Kushtetuta në nenet 131/f dhe 134/1/g parashikon mundësinë që individët, pas shterimit të mjeteve juridike, mund t'i drejtohen edhe Gjykatës Kushtetuese, e cila ka të drejtën e gjykimit përfundimtar për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt, çka përbën një mjet ankimi efektiv.

6. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

6.1 Gjykata referuese nuk ka parashtruar mjaftueshëm arsye serioze për antikushtetushmërinë e pikës 2 të nenit 80 të

KPP-së, pasi nuk ka sqaruar se deri në ç'masë dhe drejtim është cenuar parimi i proporcionalitetit në ushtrimin e së drejtës së ankimit nga palët.

6.2 Kufizimi i së drejtës së ankimit kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë në thelb nuk e cenon procesin gjyqësor. Po ashtu ai nuk bie ndesh as me praktikën e GJEDNJ-së.

6.3 Ndonëse vendimi penal i dhënë nga Gjykata e Lartë në kuadër të ushtrimit të juridiksionit fillestar përbën një vendim të formës së prerë, ligjvënësi nuk e ka përjashtuar mundësinë e rishikimit të tij nga një tjetër Kolegj i Gjykatës, mbi bazën e rekursit apo kërkesës për rishikim, për shkaqe ligjore ose të faktit, në rastet e parashikuara nga nenet 432 dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale.

6.4 Nëse do të niseshim nga analiza *a contrario* e çështjes dhe do të mbështeteshim vetëm në interpretimin literal të nenit 141/1 të Kushtetutës, do të gjendeshim para vakumit ligjor nëse juridiksioni i Gjykatës së Lartë do t'u referohej vetëm personave që kryejnë vepra në ushtrimin e detyrës, apo çdo lloj vepre penale, si dhe nëse personat ndaj të cilëve shtrihet ky juridiksion do të ishin subjekte "të përhershme" të procedimit penal të ushtruar nga Gjykata e Lartë në rolin e gjykatës së shkallës së parë, apo nëse do të ishin subjekte të këtij procedimi për sa kohë ushtrojnë funksionet e tyre. Në kushtet kur Kushtetuta nuk e bën një diferencim të tillë, neni 75/b/2 i KPP-së ka rregulluar situatën ligjore duke e lidhur ushtrimin e juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë me statusin që kanë subjektet në kohën e gjykimit.

6.5 Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj e ka trajtuar juridiksionin fillestar të gjykatës si pjesë të parimit të miradministrimit të drejtësisë e konkretisht të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për më tepër, në nenet 80–82 të KPP-së ligjvënësi ka parashikuar që në rastet e pamundësisë së ndarjes së procedimeve penale, t'ia delegojë diskrecionin e shqyrtimit të çështjes gjykatës e cila ka një kompetencë më specifike në raport me llojin dhe subjektin e veprave penale (p.sh. Gjykatës për Krime të Rënda etj.).

6.6 Pretendimi i gjykatës referuese se neni 80/2 i KPP-së paraqet pengesë ligjore për gjykatën që të veçojë çështjen ndaj dy të pandehurve që nuk janë deputetë, në mungesë edhe të marrëveshjes së palëve, nuk qëndron. Neni 93 parashikon në mënyrë alternative kushtet në të cilat gjykatës i lejohet diskrecioni të bëjë veçimin e çështjeve penale. Sipas pikës 2 të këtij neni, ndarja e çështjeve penale mund të bëhet edhe me marrëveshje të palëve kur gjykata e çmon të dobishme për qëllimet e shpejtësisë së gjykimit. Ky nuk është një kusht *sine qua non* të cilit gjykata duhet t'i nënshtrohet shprehimisht, por në çdo rast ligjvënësi i le hapësirë gjykatës për vlerësimin lidhur me ecurinë e procesit penal, në mbështetje të parimit të miradministrimit të drejtësisë. Në rastin konkret, për shkak të cilësimit të veprës penale si të kryer në bashkëpunim, është i pamundur përcaktimi i saktë i përgjegjësisë penale në rast se nuk administrohen të gjitha rrethanat e faktet e çështjes në unitet me njëra-tjetrën.

7. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

7.1 Neni 80/2 i KPP-së nuk përbën pengesë për realizimin e një procesi të rregullt ligjor për të pandehurit që nuk janë deputetë për shkak të kufizimit të së drejtës së tyre të ankimit, pasi garancitë kushtetuese për procesin e rregullt ligjor janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në dispozitat e këtij Kodi.

7.2 Neni 80/2 përcakton që vetëm në rastet e pamundësisë objektive, të parashikuara shprehimisht në nenet 79/1 dhe 92 të KPP-së, subjektet e tjera gjykohen së bashku me subjektet e juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë dhe vetëm për lidhjet me këta të fundit. Në kushtet kur kjo dispozitë parashikon në mënyrë të shprehur rastet përjashtimore të gjykimit nga Gjykata e Lartë të personave që nuk janë subjekt i juridiksionit fillestar, gjykimi i tyre nuk mund të konsiderohet se kryhet nga një gjykatë jo e krijuar me ligj.

7.3 Parashikimi i gjykimit të këtyre subjekteve së bashku me ata të juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë është i parashikuar në raste përjashtimore edhe nga neni 2 i protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e gjykatës referuese

8. Siç është shprehur në mënyrë të vazhdueshme Gjykata në jurisprudencën e saj, kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin

e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

9. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 55, datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke e vlerësuar legjitimimin e gjykatës referuese në këndvështrim të kritereve të mësipërme, Gjykata vëren se në rastin konkret gjykatës referuese i është kërkuar të ushtrojë juridiksionin fillestar për gjykimin e çështjes penale ndaj shtetasve Tom Doshi, Mark Frroku dhe Durim Bami, të akuzuar për veprën penale "Kallëzim i rremë", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 305 dhe 25 të Kodit Penal. Në kushtet kur njëri prej të pandehurve ka cilësinë e deputetit, bazuar në nenin 141/1 të Kushtetutës dhe nenin 75/b/2 të KPP-së, Gjykata e Lartë është gjykata kompetente për gjykimin e akuzës penale ndaj tij. Po ashtu, sipas nenit 80/2 të KPP-së në rastin konkret ndodhemi para procedimeve të lidhura, ku njëri është në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit është gjykata kompetente edhe për gjykimin e procedimeve të tjera. Për pasojë, neni 80/2 i KPP-së është i zbatueshëm në rastin konkret pasi lidhet drejtpërdrejt me përcaktimin e gjykatës kompetente për gjykimin në themel të kësaj çështjeje penale, çka është parakusht për respektimin e së drejtës së palëve për një proces të drejtë dhe për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e caktuar me ligj. Në këto kushte, në kuptim të plotësimit të kritereve për legjitimimin e saj, Gjykata vlerëson se gjykata referuese ka identifikuar dispozitën ligjore të zbatueshme në rastin konkret, si dhe ka parashtruar argumente për sa i përket jokushtetutshmërisë së dispozitës, të cilat, sipas saj, mbështesin pretendimet për cenimin e normave dhe të parimeve konkrete kushtetuese.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

11. Sipas gjykatës referuese neni 80/2 i KPP-së përbën pengesë për realizimin e një procesi të rregullt ligjor për të pandehurit që nuk janë deputetë. Juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë është përjashtim i përcaktuar nga Kushtetuta, bazuar vetëm në cilësinë e subjektit të pandehur, ndërkohë që neni 80/2 i KPP-së bëhet shkak për shtrirjen e juridiksionit fillestar edhe tej subjekteve që parashikon shprehimisht Kushtetuta. Shqyrtimi i një çështjeje nga një gjykatë jo kompetente apo nga një gjykatë, kompetenca e së cilës është përcaktuar në një

dispozitë ligjore që del tej parashikimeve të përcaktuara në nenin 141/1 të Kushtetutës, ka të bëjë në thelb me mosrespektimin e së drejtës kushtetuese për t'u gjykuar nga "një gjykatë e caktuar me ligj".

12. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*". Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion të parashikuara nga rendi juridik, si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda fushës të cilës ai është i detyruar të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar (*shih vendimin nr. 44, datë 16.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Përcaktimi i saktë i kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, sipas së cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit (*shih vendimin nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetë kompetenca lëndore e gjykatës është e lidhur ngushtë me kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete. Në këtë kontekst, fjala "ligj", sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e çështjeve penale ka të bëjë me rrethin e akuzave, shqyrtimi i të cilave është atribut i gjykatave të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Në përputhje me sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar të pandehurin në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës, ajo nuk është "e krijuar me ligj", sipas kuptimit të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vlerëson se në rastet e gjykimit të çështjeve penale ndaj disa kategori funksionarësh publikë Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar, i cili i është njohur nga neni 141/1 i Kushtetutës. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, neni 80 i KPP-së ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatën kompetente edhe në rastin e bashkimit të procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Në kushtet kur në shqyrtimin e këtyre çështjeve kompetenca lëndore e Gjykatës së Lartë është e parashikuar me ligj, nuk ka cenim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj. Për rrjedhojë, ky pretendim i gjykatës referuese është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e së drejtës së ankimit

16. Sipas gjykatës referuese neni 80/2 i KPP-së kufizon të drejtën e ankimit të të pandehurve që nuk janë deputetë dhe kjo bëhet në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe qëllimin e parashikuar nga nenet 17, 43 dhe 141/1 të Kushtetutës, si dhe në kundërshtim me nenin 6/1 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të Protokollit nr. 7 të kësaj Konvente. Sipas saj, në rastet kur Gjykata e Lartë shqyrton akuzat penale ndaj subjekteve të parashikuara në nenin 141/1 të Kushtetutës, vendimi i saj është përfundimtar, i formës së prerë dhe i paankimueshëm për çështje fakti ose ligji në një gjykatë më të lartë të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Kompetenca e Gjykatës së Lartë për gjykimin si shkallë e parë dhe e fundit e akuzave penale ndaj deputetëve, është një kompetencë kushtetuese që nuk mund të zgjerohet apo ngushtohet me ligj, ndaj neni 80/2 i KPP-së është jokushtetues për pjesën që zgjeron një kompetencë të mirëpërcaktuar kushtetuese të Gjykatës së Lartë, duke mos pasur një autorizim të shprehur kushtetues për ta bërë këtë, e duke sjellë për pasojë kufizimin e së drejtës së ankimit të subjekteve që nuk përfshihen shprehimisht në nenin 141/1 të Kushtetutës.

17. Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një

vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata ka theksuar se e drejta themelore e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se *"...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit"* ose *"...nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë* ". Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Kushtetuta i garanton individit të drejtën për t'u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij.

18. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që se drejta e ankimit nuk mund të jetë subjekt i kufizimeve. Kreu i të drejtave themelore, i parashikuar në Kushtetutë, ka një përmbajtje të tillë që, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi. Në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese, siç është ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte themelore, (*shih vendimin nr. 27. datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Jo vetëm kaq, por formulimi dhe kuptimi juridik i nenit 17 të Kushtetutës është i tillë që përfshin të gjitha të drejtat themelore përderisa thekson se kufizimi i tyre nuk mund të prekë thelbin e së drejtës. Në vijim të këtij interpretimi vijnë edhe parashikimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta të kodeve përkatëse të procedurës lidhur me kufizimin e së drejtës së ankimit (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar se për të justifikuar cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, është e domosdoshme të përmbushen disa kushte si: kufizimi të realizohet me ligj, të jetë bërë për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar, si dhe të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore. Qëllimi i nenit 17 të Kushtetutës është që në rastin e kufizimeve jo vetëm duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht organi më i lartë ligjvënës (*shih vendimin nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vlerëson se për këta të pandehur ka kufizim të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, por ky kufizim që i është bërë njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte nga legjislacioni i brendshëm ndjek një qëllim të ligjshëm dhe nuk cenon thelbin e kësaj të drejte.

21. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes të të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, është shprehur se ligjvënësi duhet të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, gjë që do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që si rezultat i tij i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit (*shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues, ku në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për

pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, çka përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Si përjashtim, bazuar po në nenin 141/1 të Kushtetutës dhe nenin 75/b të KPP-së, Gjykata e Lartë ka edhe juridiksion fillestar në rastin kur gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, për vendimet e të cilave, duke qenë se shqyrtohen, edhe pse si gjykatë e zakonshme, nga organi më i lartë i piramidës gjyqësore, nuk mund të parashikohet ankim në një gjykatë të lartë, por vetëm në Gjykatën Kushtetuese dhe vetëm për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në lidhje me këto subjekte Gjykata është shprehur edhe më parë se fakti që në rastin e shqyrtimit të këtyre çështjeve nga Gjykata e Lartë, si gjykatë e shkallës së parë, nuk është parashikuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky qëndrim i Gjykatës është bazuar edhe në nenin 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, sipas të cilit për vendime të dhëna në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, siç është rasti konkret i juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë, për gjykimin e funksionarëve të lartë të shtetit, këto vendime janë të paankimueshme. Në këtë drejtim edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se shtetet kontraktuese gëzojnë, në parim, një hapësirë vlerësimi në përcaktimin se si e drejta e ankimit, e parashikuar në nenin 2 të protokollit 7 të KEDNJ-së, duhet të ushtrohet (*shih Krombach kundër Francës, vendim i datës 13 shkurt 2001, §96*).

23. Megjithatë, Gjykata vëren se në pikën 2, të nenit 80, të KPP-së thuhet: "*Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë dhe të tjerat në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kompetente është kjo e fundit.*" Bazuar në këtë dispozitë Gjykata e Lartë është kompetente për gjykimin në themel edhe të akuzave penale ndaj të pandehurve, të cilët edhe pse nuk përfshihen në rrethin e subjekteve të përcaktuara shprehimisht në nenin 141/1 të Kushtetutës, i nënshtrohen këtij juridiksioni për shkak të lidhjes mes procedimeve penale në shqyrtim. Për pasojë, në raste të tilla, Gjykata vlerëson se për këta të pandehur ka kufizim të së drejtës së ankimit në një gjykatë më të lartë, ndaj ajo duhet të vlerësojë nëse ky kufizim që i është bërë njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte nga legjislacioni i brendshëm ndjek një qëllim të ligjshëm dhe nëse cenon thelbin e kësaj të drejte.

24. Gjykata vëren se instituti i bashkimit të procedimeve është i parashikuar në nenin 79 të KPP-së, sipas të cilit organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve: a) kur vepra penale për të cilën zhvillohet procedimi është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre ose kur disa persona në mënyrë të pavarur kanë shkaktuar veprën; b) kur një person akuzohet për disa vepra penale; c) kur një person akuzohet për disa vepra, nga të cilat një pjesë janë kryer për të realizuar ose për të mbuluar të tjerat, ose për t'i siguruar fajtorit apo të tjerëve përfitime të paligjshme ose mosdënimin. Kurse neni 80 i KPP-së përcakton gjykatën kompetente në rastin e bashkimit të procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme. Sipas tij në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e gjykatës për krimet e rënda dhe procedurat e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është gjykata e krimeve të rënda. Kurse sipas pikës 2 të po këtij neni, në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë në kompetencë të gjykatave të shkallës së parë dhe të tjerat në kompetencë të Gjykatës së Lartë, kompetente është kjo e fundit. Megjithatë, Gjykata vëren se bashkimi lejohet vetëm për ato çështje që janë në të njëjtën gjendje dhe shkallë të procesit, por në zbatim të nenit 93 të KPP-së gjykata edhe kryesisht mund të vendosë ndarjen e çështjeve, kur nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve, si dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga kjo dispozitë.

25. Në rastet e parashikimit të juridiksionit fillestar për gjykatat më të larta, Gjykata ka vlerësuar se qëllimi kryesor i këtij përjashtimi është shkurtimi i afateve për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke garantuar njëkohësisht edhe një gjykim në shkallë të parë më të kualifikuar e më profesional. Është në interes të administrimit të drejtësisë dhe të funksionimit normal të mekanizmave shtetërore që rastet e këtij lloji, mjaft të kufizuara në numër dhe relativisht të

lehta për t'u zgjidhur, të trajtohen me përparësi dhe vëmendje të veçantë. Ky përjashtim është në përputhje edhe me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilët, ndër të tjera, kërkohet zhvillimi i gjykimit brenda një afati sa më të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 14, datë 5.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po ashtu, Gjykata vlerëson se në një interpretim *a contrario*, pra nëse do të pranohej që në raste të tilla të ishte kompetente një gjykatë më e ulët, për shkak të cilësisë së ndryshme të personave të akuzuar, atëherë kjo do të binte ndesh me parashikimin kushtetues të nenit 141/1, i cili ka përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatë të shkallës së parë për gjykimin e një kategorie të caktuar çështjesh penale dhe që si i tillë nuk mund të anashkalohet apo të mos respektohet nga dispozita ligjore. Për pasojë, cenimi i së drejtës së ankimit për një kategori subjektesh, për shkak të zbatimit të nenit 80/2 të KPP-së, buron drejtpërdrejt nga ky parashikim kushtetues.

27. Balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve është siguruar nga gjetja nga legjislatori e pikës së ekuilibrit midis së drejtës së ankimit dhe interesit të dhënies së drejtësisë, që realizohet me anë të zhvillimit të një procesi të drejtë ligjor. Po ashtu, mjeti i përdorur nuk është joproporcional, pasi në raste të tilla Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen duke vepruar si një gjykatë fakti, duke zbatuar për sa është e mundur rregullat e gjykimit në shkallë të parë dhe duke respektuar të gjitha kërkesat për një proces të rregullt ligjor, si e drejta e mbrojtjes, e barazisë së armëve dhe e kontradiktoritetit në gjykim, dhe duke marrë vendimin në bazë të vlerësimit të provave të administruara. Gjykata vlerëson se garancitë që u janë njohur nga Kushtetuta një kategorie të caktuar funksionarësh publikë, zbatohen në rastet e bashkimit të procedimeve edhe ndaj të pandehurve të tjerë. Edhe pse ky lloj gjykimi përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit penal, Gjykata e Lartë i shqyrton këto çështje si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural, çka është edhe funksioni i saj kushtetues, duke respektuar standardet e një procesi të drejtë ligjor. Në këto raste Gjykata e Lartë heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kufizimi që i bëhet së drejtës së ankimit për shkak të zbatimit të nenit 80/2 të KPP-së, plotëson kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, për rrjedhojë kërkesa është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,[1]

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi , Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

VENDIM
Nr. 63, datë 4.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 6.7.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 39 Akti, që i përket:

[1] Gjyqtarja A. Xhoxhaj ishte për rrëzimin e kërkesës, për shkak të moslegjitimimit të kërkueses.

KËRKUES: Bardhyl Ibra

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 582 akti, datë 9.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Konstatimi i cenimit të aksesit si rezultat i mosdërgimit nga administrata gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë të ankimit kundër vendimit nr. 700 akti, datë 20.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë të rekursit kundër vendimit nr. 582 akti, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Detyrimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor material dhe moral në shumën 1.500.000 lekë, të shkaktuar nga veprimet e qëllimshme të administratës shtetërore.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 15/2, 17/2, 18/1, 18/2, 18/3, 25, 42/1, 42/2, 43, 44, 131/f, 132/1, 134/1/g dhe 145/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2, 25, 27 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 246/1 i Kodit Penal (KP), të ndryshuar dhe ndiqet penalisht nën masën e sigurisë "Arrest shtëpie". Gjatë procesit ai i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, kërkesë e cila nuk është pranuar. Kërkuesi është njoftuar zyrtarisht për vendimin e prokurorit të Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 18.2.2015 dhe për vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm në datën 13.3.2015.

2. Kundër vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar gjithashtu edhe zëvendësimin e prokurorit të çështjes. Në seancën gjyqësore të datës 20.5.2015 kërkuesi ka paraqitur kërkesë edhe për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi i çështjes. Ndërkohë, në seancën gjyqësore të datës 9.9.2015, Prokuroria ka paraqitur aktin procedural "Njoftim për pjesëmarrje në gjykim", sipas të cilit çështja penale në ngarkim të kërkuesit kishte kaluar në shqyrtim gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Për rrjedhojë, Prokuroria i ka kërkuar gjykatës shpalljen e moskompetencës, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. 582 akti, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkuesi ka depozituar rekurs kundër këtij vendimi.

3. Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 700 akti, datë 20.10.2015, për shkak të mosparaqitjes së palëve ndërgjyqëse, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale me objekt përjashtimin e gjyqtares M.L. nga gjykimi i çështjes penale nr. 582, datë 15.4.2015. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka depozituar ankim.

II

4. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 25.3.2016, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4.1 Është cenuar *e drejta e ankimit*, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 419 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi vendimi nr. 582 akti, datë 9.9.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin u shpall moskompetenca për gjykimin e kërkesës për përjashtimin e prokurorit nuk shprehej për të drejtën e kërkuesit për ta kundërshtuar atë në një shkallë më të lartë.

4.2 Është cenuar *e drejta e aksesit në gjykatë*, pasi sipas nenit 420 të KPP-së, mospranimi i ankimit apo i rekursit nuk është kompetencë e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por respektivisht e Gjykatës së Apelit ose e Gjykatës së Lartë. Për më tepër, sipas nenit 419 të KPP-së, aktet e procedimit bashkë me ankimin dërgohen nga gjykata që ka dhënë vendimin në gjykatën që do të shqyrtojë çështjen brenda 10 ditëve.

4.3 Shqyrtimi i çështjes njëkohësisht nga dy gjyqtarë bie ndesh me nenin 18/2 të KPP-së, sipas të cilit gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit.

4.4 Punonjësit e administratës kanë cenuar të drejtat kushtetuese, për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, kërkuesi duhet të dëmshpërblehet në shumën prej 1 500 000 lekësh për dëmin e pësuar.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

5. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

6. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata Kushtetuese ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në vështrim të standardeve të mësipërme Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues për kërkimin për dëmshpërblimin, sepse kjo është një çështje që i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimit nr. 582, datë 9.9.2015, Gjykata çmon se nuk mund të vijojë analizën, pasi në referim të nenit 131/f të Kushtetutës ajo është kompetente për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

8. Ndërkohë, Gjykata vlerëson se pretendimet e tjera të kërkuesit lidhen me të drejtën për akses në gjykim dhe si të tilla, *prima facie*, ato bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

9. Kërkuesi ka pretenduar se qëndrimi i kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosdërgimin e ankimit dhe të rekursit të paraqitur prej tij sepse nuk plotësonin kushtet për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë, i ka cenuar të drejtën e aksesit.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas jurisprudencës kushtetuese e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me

themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga rrethanat e çështjes konkrete Gjykata vëren se kërkuesi ka paraqitur rekurs kundër vendimit nr. 582, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes penale dhe ankim kundër vendimit nr. 700, datë 20.10.2015 të të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vendosi pushimin e çështjes me objekt gjykimi përjashtimin e gjyqtares. Nga aktet bashkëngjitur kërkesës rezulton se kërkuesi në datën 19.9.2015 ka depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dy kërkesa drejtuar kryetarit të asaj gjykate, ku kërkon të informohet në lidhje me veprimet procedurale të kryera lidhur me ankimin dhe rekursin e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12. Gjykata konstaton se me shkresën nr. 1595/1, datë 22.9.2015 të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuesi është informuar fillimisht se: *"… ju bëjmë me dije se për dosjen penale nr. 582, datë 9.9.2015 është shpallur moskompetenca dhe aktet janë dërguar në Gjykatën e Elbasanit, e cila është kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkese*". Po ashtu, Gjykata vëren se me shkresën nr. 1684/1prot, datë 23.10.2015 të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuesi është informuar: "*Nga ana juaj, me shkresën nr. 1684 prot., datë 1.10.2015, është paraqitur rekurs kundër vendimit nr. 582 akti, datë 9.9.2015, i cili i drejtohet Gjykatës së Lartë. Në bazë të nenit 431 të KPP-së janë objekt rekursi të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatës për mosmarrëveshjet lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, si dhe rastet e veçanta të parashikuara nga ligji. Për më tepër në vendim nuk parashikohet e drejta e ankimit dhe në këto kushte rekursi juaj nuk mund të vihet në lëvizje*". Në lidhje me informacionin që kërkuesi ka kërkuar për fazën procedurale në të cilën ndodhej ankimi kundër vendimit nr. 700 akti, datë 20.5.2015, Gjykata vëren se me shkresën nr. 1236/1 prot., datë 15.6.2016 të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkuesi është vënë në dijeni se "*Dosja është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. 2245/1, datë 28.12.2015*.".

13. Gjykata, referuar nenit 413 të Kodit të Procedurës Penale, vëren se akti i ankimit paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar. Në lidhje me dërgimin e akteve, neni 419 i KPP-së parashikon se është gjykata që ka dhënë vendimin ajo që brenda 10 ditëve i dërgon gjykatës që do të shqyrtojë çështjen aktet e procedimit dhe ankimin.

14. Bazuar në parashikimin e mësipërm ligjor, Gjykata vlerëson se normat procedurale kanë përcaktuar sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin si organin që ka kompetencë regjistrimin e ankimit të paraqitur kundër vendimit apo dërgimin e akteve në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin.

15. Për sa i takon rolit të kancelarit të gjykatës në veprimet e mësipërme procedurale, Gjykata vëren se KPP-ja nuk ka përcaktuar shprehimisht ndonjë kompetencë. Referuar nenit 37 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Gjykata konstaton se kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë, kurse sipas nenit 38 kompetencat e tij përfshijnë: *"... b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar; c) ndjek ecurinë e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara në sekretarinë gjyqësore, në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligj; ç) shpall listën e ekspertëve të licencuar, sipas fushave përkatëse; d) mbikëqyr disiplinën në punë të punonjësve të administratës gjyqësore; dh) siguron mjedis të veçantë brenda gjykatës për studimin e dosjeve gjyqësore nga avokatët, prokurorët, ekspertët, përfaqësuesit e palëve ose personat që e kanë këtë të drejtë; e) miraton orarin e shërbimeve që përmbushen nga strukturat e administratës gjyqësore dhe përcakton orarin e pritjes së popullit*.".

16. Në vështrim të sa më sipër Gjykata vlerëson kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kryer veprime që bien në kundërshtim me përmbajtjen e rregullave procedurale dhe praktikën gjyqësore që garantojnë kontrollin gjyqësor në gjykatat më të larta të pretendimeve të palëve në proces lidhje me kompetencën e gjykatës. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se aktet e nxjerra prej kancelarit i kanë mohuar kërkuesit të drejtën e aksesit në gjykatë.

17. Për rrjedhojë, arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkuesit Bardhyl Ibra për akses në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

VENDIM
Nr. 64, datë 4.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.6.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 30 Akti, që i përket:

KËRKUES: Uran Dragoni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Avokatura e Shtetit, Bujar Dosti

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 2466, datë 18.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 104, datë 16.1.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 41/1/2, 42/1, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për konstatimin absolutisht të pavlefshme të shitjes në ankand të objekteve të ndërtuara nga shteti në truallin e tij dhe ushtrimin e së drejtës së parablerjes, e drejtë e cila i ishte njohur me vendimin nr. 1050, datë 30.12.1994 të KKKP-së të Bashkisë Tiranë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 558, datë 3.3.2000, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 978, datë 24.10.2000, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 543, datë 16.5.2002, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim po në atë gjykatë.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 260, datë 27.2.2003, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 558, datë 3.3.2000.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 905, datë

11.5.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1419, datë 3.12.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 558, datë 3.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 881, datë 5.7.2006, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1419, datë 3.12.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 558, datë 3.3.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë dhe konstatuar pavlefshmërinë e shitjes në ankand të objektit në favor të të paditurit. Po ashtu gjykata ka urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, si dhe detyrimin e AKP-së të respektojë të drejtën e parablerjes të ish-pronarit të truallit.

9. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimeve të mësipërme, e cila është pranuar nga ajo gjykatë me vendimin nr. 1634, datë 15.12.2006.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit të interesuar për sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, arsyeton se *"...në pjesën arsyetuese të vendimit bëhet fjalë për pavlefshmërinë e kontratës së shitjes nr. 5682rep, 1588kol, datë 23.9.1999 lidhur midis AKP-së e Uzinës Mekanike të Gjeologjisë, si palë shitëse, dhe Bujar Dosti, si palë blerëse, dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme*".

11. Trashëgimtarët e ish-pronarit H.SH. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: "*Pavlefshmëri absolute e kontratës së shitjes së truallit nr. 7598rep., 2188kol., datë 21.12.1999, detyrimi i të paditurit të na njohë pronarë të një trualli me sipërfaqe 5541 m² dhe fshirjen nga regjistri hipotekor të pronës së këtij të padituri*". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2085, datë 16.3.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova.

12. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 75, datë 20.1.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

13. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1827, datë 11.11.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit.

14. Për shkak të mosvënies në ekzekutim të vendimit nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: "*Realizimi i së drejtës së parablerjes. Detyrimi i palës së paditur, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, për të respektuar të drejtën e parablerjes së ish-Uzinës Mekanike Gjeologjike Tiranë, me sipërfaqe 10980 m², duke më shpallur fitues pa ankand si ish-pronar truall*". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10368, datë 19.12.2011, ka vendosur rrëzimin e padisë.

15. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2466, datë 18.10.2012, ka vendosur prishjen e vendimit civil dhe pushimin e gjykimit.

16. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-104, datë 16.1.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

II

17. ***Kërkuesi*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 7.3.2016, duke pretenduar se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë respektuar standardet e procesit e rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi parashtron si vijon:

17.1 Gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me të drejtën e parablerjes së objekteve nga ish-pronari i truallit. Ato e transformuan natyrën e vërtetë të mosmarrëveshjes, duke e nxjerrë atë jashtë përcaktimeve ligjore të vendimit nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil. Edhe pse e drejta e parablerjes ishte përcaktuar shprehimisht me vendimin e KKKP-së, ajo nuk është vënë në ekzekutim si rezultat i veprimeve abuzive të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP-ja). Për më tepër, mungesa e referimit në urdhërimet e vendimit nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil, por në akte nënligjore, ka sjellë cenimin e së drejtës së pronësisë.

17.2 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike kanë refuzuar të vënë në zbatim vendimin nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka konstatuar pavlefshmërinë e shitjes në ankand të objektit në favor të të paditurit, si dhe ka urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe detyrimin

e AKP-së të respektojë të drejtën e parablerjes të ish- pronarit të truallit. Kjo ka çuar në cenimin e pritshmërive të ligjshme për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

17.3 Është cenuar *barazia e armëve*, pasi subjekti i interesuar u shpall fitues i ankandit, sepse ishte personi i parë sipas renditjes së alfabetit dhe se shprehu gatishmërinë për të bërë pagesën e objekteve menjëherë. Kurse moskualifikimi i kërkuesit u bazua në argumentin e vetëm se nuk parashtroi gatishmëri për pagesë të menjëhershme, por me dy këste.

17.4 Është cenuar *e drejta e aksesit* si rezultat i mosreflektimit në bazën ligjore të kontratës së shitjes të ligjit nr. 7698/1993 dhe, po ashtu, i mosmarrjes në konsideratë nga gjykatat të rregullimeve të këtij ligji mbi të drejtën e parablerjes.

17.5 Është cenuar *parimi i proporcionalitetit*, pasi gjykatat haptazi nuk kanë respektuar nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit qëllimi që kërkohet të arrihet duhet të jetë jo vetëm i domosdoshëm, domethënë për arsye publike, por edhe mënyra më e përshtatshme për të arritur këtë qëllim. Vendimet gjyqësore kanë balancën midis së drejtës së kufizuar dhe mbrojtjes së të drejtave ligjore për të qenë subjekt i vetëm i ushtrimit të së drejtës së parablerjes të objekteve të ish-uzinës.

18. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes***, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, por vetëm praktikën e komunikimit me Këshillin e Ministrave, nga e cila rezulton se "*dokumentacioni i vlerësimit të objektit nr. 2 të ish–Uzinës Mekanike dhe Gjeologjike Tiranë është kthyer për rivlerësim nga Ministria e Financave, sepse kontrata e shitjes së këtij objekti është deklaruar e pavlefshme me vendimin nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pretendimi i kërkuesit për vlerësim dhe jo për rivlerësim është i gabuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka specifikuar detyrimin e AKP-së për të lidhur kontratën e shitjes me pronarët e truallit me të njëjtin çmim me të cilin është lidhur kontrata e parë për shitjen e objektit në vitin 1999*".

19. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ka prapësuar me shkrim si vijon:

19.1 Argumentet e parashtruara nga kërkuesi nuk kanë lidhje me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, por me fakte e rrethana të ndodhura jashtë procesit gjyqësor, të cilat nuk janë objekt i cilësimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

19.2 Pretendimet e parashtruara nga kërkuesi kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e të cilave nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

19.3 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuesi nuk argumenton se në çfarë mënyre procesi në Gjykatën e Lartë ka cenuar kontradiktoritetin në gjykim.

20. ***Subjekti i interesuar, Bujar Dosti*** ka prapësuar me shkrim se:

20.1 Pretendimi i kërkuesit se vendimet gjyqësore janë kontradiktore është i gabuar dhe i pabazuar, sepse pronësia mbi truallin në fjalë ka qenë objekt gjykimi në një proces tjetër gjyqësor, të ndryshëm nga ai objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese. Fakti që Kolegji Civil nuk ka pranuar rekursin e kërkuesit nënkupton se mbështet arsyetimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas të cilit nëse do të zbatohet vendimi nr. 881/2006 i Kolegjit Civil, palët duhet të kthehen në gjendjen e mëparshme, pra kthimi i objekteve shtetit. E drejta e parablerjes i takon kërkuesit dhe nuk i është cenuar apo kufizuar, çka do të thotë se ai e ruan atë të drejtë nëse organet kompetente do të bëjnë privatizimin e sendit objekt përmes ankandit.

20.2 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë zhvillimit të procedurave të ankandit është i pabazuar, pasi nuk ka të bëjë me proceset gjyqësore objekt kundërshtimi.

20.3 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e sigurisë juridike, pasi kërkuesi e lidh me moszbatimin e vendimit nr. 881/2006 të Kolegjit Civil nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, institucione me të cilat ai ka pasur korrespondencë të vazhdueshme. Në këtë rast pritshmëria e kërkuesit është e ndryshme nga ajo që mbrohet në procese gjyqësore.

20.4 Edhe pretendimi për zbatimin e standardeve të ndryshme nga gjykatat është i gabuar, për faktin se vendimet e Kolegjit Civil kanë pasur objekte të ndryshme gjykimi, rrjedhimisht edhe qëndrime të ndryshme.

20.5 Për sa i takon pretendimit për cenimin e aksesit, kërkuesi ka marrë pjesë në të gjitha proceset dhe i është drejtuar juridiksionit të zakonshëm me disa padi, të cilat janë gjykuar në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

20.6 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit, pasi e drejta e parablerjes të kërkuesit i është konfirmuar nga të gjitha vendimet gjyqësore, përfshi edhe ato objekt kundërshtimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

21. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/ 2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

22. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013; nr. 38, datë 6.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ai legjitimohet t'i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

25. Sipas kërkuesit autoritetet shtetërore, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike kanë refuzuar të vënë në zbatim vendimin nr. 881, datë 5.7.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka konstatuar pavlefshmërinë e shitjes në ankand të objektit në favor të të paditurit, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe detyrimin e AKP-së të respektojë të drejtën e parablerjes të ish-pronarit të truallit. Kjo ka çuar në cenimin e pritshmërive të ligjshme për të ushtruar të drejtën e parablerjes.

26. Gjykata, referuar jurisprudencës kushtetuese, rithekson se siguria juridike lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 41, datë 6.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se për sa kohë vendimi nr. 881, datë 5.7.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili i ka njohur kërkuesit të drejtën e parablerjes, nuk është shfuqizuar, kërkuesi ka të drejtë të shfrytëzojë mjetet juridike që lidhen me ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë për ta bërë efektive të drejtën e parablerjes.

28. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

29. Kërkuesi ka pretenduar se ai u skualifikua nga procedurat e ankandit për faktin se nuk ishte i gatshëm për pagesë të menjëhershme të të gjithë shumës, por me dy këste. Kurse subjekti i interesuar u shpall fitues i ankandit, sepse ishte personi i parë sipas renditjes së alfabetit dhe se shprehu gatishmërinë për të bërë pagesën e objekteve menjëherë.

30. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë përparësi të konsiderueshme ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një balancë/ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në vështrim të standardit të mësipërm dhe rrethanave të çështjes Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për mostrajtim të njëjtë me subjektin e interesuar gjatë procedurës së ankandit, është i natyrës ligjore dhe si i tillë ai ka marrë përgjigje gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë kuptim, Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim është i pabazuar.

D. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

32. Sipas kërkuesit e drejta për akses është cenuar si rezultat i mosreflektimit në bazën ligjore të kontratës së shitjes të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe, po ashtu, i mosmarrjes në konsideratë nga autoritetet shtetërore dhe gjykatat e zakonshme të rregullimeve të këtij ligji mbi të drejtën e parablerjes. Kjo ka sjellë si pasojë mospërfitimin e fryteve pasurore që burojnë nga e drejta e parablerjes.

33. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata, duke e vlerësuar pretendimin e kërkuesit në vështrim të sa më sipër, çmon se ai ka të bëjë me çështje të interpretimit të ligjit dhe të zbatimit të tij në çështjet konkrete, si dhe me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave dhe si i tillë i takon juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

E. Për pretendimin e cenimit të parimit të proporcionalitetit

35. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë respektuar nenin 17 të Kushtetutës, duke cenuar për rrjedhojë balancën midis së drejtës së kufizuar dhe mbrojtjes së të drejtave ligjore për të qenë subjekt i vetëm i ushtrimit të së drejtës së parablerjes të objekteve të ish- uzinës.

36. Sipas jurisprudencës kushtetuese në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 52, datë 5.12.2012; nr. 1 datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata çmon të nevojshme të ritheksojë se pretendimi për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit analizohet në kontekstin e kontrollit abstrakt të normës, ku ajo vlerëson nëse strategjia e ndërhyrjes së ligjvënësit ka respektuar ose jo kriteret e mëposhtme: i) *nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta, ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.*

37. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit nga autoritetet shtetërore apo gjykatat në çështjen objekt shqyrtimi, e cila është gjykim konkret, është i pabazuar.

38. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 169, datë 31.10.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-s NR. 103, DATË 23.6.2016, "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e shoqërive OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 103,

datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19, germa "l", ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat, për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- OSHEE sh.a., në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në rregulloren "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", sa i përket ndërtimit të platformës IT.

- Parashikimet e nenit 20 të rregullores "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", mund të adresohen në marrëveshjen që do të lidhet në përfundim të një procedure prokurimi.

- OSHEE sh.a., në shkresën e saj nr. 24041 prot., datë 21.10.2016, drejtuar ERE-s, ka kërkuar shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s me 60 ditë.

- OST sh.a., është shprehur me shkresën nr. 613 prot., datë 29.9.2016, protokolluar në ERE me nr. 701 prot., datë 30.9.2016, se OST sh.a. është ende në fazën e implementimit të platformës IT *on-line* dhe që referuar kontratës përkatëse parashikohet të jetë funksionale në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2017.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në nenin 20 të rregullores së miratuar me vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

2. Pika nr. 2, e vendimit 103, datë 23.6.2016, "Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", ndryshon, si më poshtë:

- Rregullorja "Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", hyn në fuqi brenda datës 31.1.2017.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a., Autoritetin e Konkurrencës dhe MEI-n për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 170, datë 31.10.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E VENDOSJES SË MASAVE ADMINISTRATIVE DHE MASËN KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE NGA TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 106/2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga drejtoritë teknike të saj dhe relacionin përkatës mbi fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për

kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të miratimit të rregullores "Për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror".

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E VENDOSJES SË MASAVE ADMINISTRATIVE DHE MASËN KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE NGA TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 106/2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", ligjit nr. 45/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative" dhe në përputhje me rregulloren "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e gazit natyror, për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e masave administrative për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror". ERE aplikon procedura të njëjta për të licencuarit në sektorin e gazit natyror në rastet e vendosjes së masave administrative.

Neni 3
Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat e aplikimit të masave administrative, metodologjinë e konstatimit e përcaktimit të tyre, si dhe masat e lehtësimit që aplikohen për masat administrative të vendosura për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në rastet e shkeljeve të ndëshkueshme me masë administrative nga ERE.

Neni 4
Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore kur përdoren do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. "Ligj" - do të thotë ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

2. "Bordi i ERE-s" - do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.

3. "ERE" - do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.

4. "Licencë" - do të thotë një e drejte e dhënë nga ERE, një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror në përputhje me dispozitat që kërkohen nga ligji nr. 102/2015, "Për gazin natyror", si dhe procedurave të licencimit të ERE-s.

5. "I licencuar" - do të thotë një person i pajisur me një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e gazit natyror.

6. "Procedurë" - do të thotë një tërësi e veprimeve të ERE-s apo të të licencuarve që kryen në zbatim të legjislacionit në fuqi.

7. "Administratori" - do të thotë sipas rastit kryetari i Bordit të ERE-s ose Bordi i ERE-s.

8. "Subjekt i interesuar" - do të thotë çdo i licencuar apo çdo person tjetër që merr shërbim apo kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

9. "Të ardhurat vjetore" - do të thotë totali i të ardhurave të gjeneruara nga shitja e të mirave të siguruara nga aktiviteti në sektorin e gazit natyror apo shërbimeve të kryera gjatë një viti financiar nga një subjekt tregtar.

10. "Xhiro mesatare ditore" - do të thotë të ardhurat mesatare të siguruara në ditë, nga shitjet përgjatë një viti financiar.

11. "Vlera fillestare e masës administrative" - do të quhet vlera e përcaktuar nga Bordi i ERE-s për efekt të llogaritjes së vlerës përfundimtare të masës administrative, e cila llogaritet sipas aneksit nr. 1 bashkëngjitur kësaj rregullore.

PJESA E DYTË
DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 5
Masat administrative

1. Çdo i licencuar mund të jetë subjekt i ndëshkimit nga ERE për një ose më shume nga shkeljet e kryera prej tij, si më poshtë:

a) dënohen nga ERE me masë administrative nga 0,1 për qind deri në 0,5 për qind të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit, shkeljet e kryera nga subjektet e licencuara:

i) kryerja e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror pa licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 22, të ligjit.

ii) veprimet e kryera nga subjektet që i nënshtrohen zbatimit të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror", të realizuara në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencë, sipas parashikimeve të neneve 50, pika 4; 75; 85, pika 4, si dhe veprimet në kundërshtim me shkronjat "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë", "f", "g" dhe "gj", të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

iii) refuzimi i paraqitjes së të dhënave, informacioneve, raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari, në kundërshtim me nenet 17, pika 1/a, 37, pika 6, 39, pika 2, 40, pika 2, 53, pikat 5 e 6, 63, pika 6, 66, 73, 87, pika 4, 92, pika 3, 95, pika 5, dhe 97, pikat 1, 2, 5, 7 e 9, të ligjit nr. 102/2015;

iv) moszbatimi i detyrimeve, lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave, sikurse kërkohet në nenet 17, pika 1, shkronja "dh"; 33, pikat 1–7, 90, pikat 10 e 11, dhe 56, pika 4, të ligjit;

v) moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas kërkesave të neneve 92, pika 11, dhe 93, pikat 2 e 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

vi) moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 30, 75, 80, pika 6, dhe 85, pika 6, të të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

vii) moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në nenet 42, pikat 1–3, 54, 64 dhe 71, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

viii) moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara, si dhe vendosja e kushteve shtesë në kontratën e furnizimit apo mosnjoftimi, në kundërshtim me nenet 76, pika 5, dhe 90, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

ix) mospublikimi i informacionit për tarifat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimi i shërbimeve të rrjetit, sikurse përcaktohet në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

x) mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 46 dhe 56, të ligjit, si dhe rregullores përkatëse të ERE-s;

xi) shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE, parashikuar në nenin 89, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xii) moszbatimi i vendimeve të ERE-s;

xiii) mosrespektimi i kërkesave të neneve 39, pikat 4 e 6, dhe 60, shkronja "ç", të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xiv) mosmarrja e masave për hartimin e programit të përputhshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë, sipas kërkesave të neneve 47, pika 1, 51, pika 5, dhe 80, pika 7, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xv) mosrespektimi i përgjegjësive të ngarkuara për operatorin e sistemit të depozitës dhe GNL-së, sipas parashikimeve të neneve 61 dhe 69, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xvi) aplikimi i kushteve shtesë në kontratat që janë drejt përfundimit, në kundërshtim me nenin 76, pika 5, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xvii) mosnjoftimi i klientëve nga furnizuesi i mundësisë së fundit, sipas kërkesave të nenit 90, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror";

xviii) mosrespektimi i kërkesave të nenit 77, të ligjit, në lidhje me ruajtjen e të dhënave;

xix) mosrespektimi i detyrimit për të lidhur kontratë, sipas nenit 96, pika 8, të ligjit, për klientët që plotësojnë kushtet, sipas pikës 1, të këtij neni;

b) ERE aplikon masë administrative progresive për çdo ditë shkelje ndaj subjekteve të ligjit nr. 102/2015, "Për gazin natyror", për rastet e mëposhtme:

i) kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje, brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast, i licencuari dënohet me masë administrative, në masën 0,1 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;

ii) kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës së taksës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me masë administrative, në masën 0,2 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.

2. Masat e masës administrative do të përcaktohen nga ERE në përputhje me aneksin 1, të kësaj rregulloreje, brenda kufijve si më poshtë:

a) jo më shumë se 0.5% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit;

b) jo më pak se 0,1% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit.

3. Masa administrative progresive për çdo ditë vonesë, nuk mund të kalojë vetë vlerën e masës administrative fillestare ose masën e 0.5% të të ardhurave të vitit paraardhës.

4. Vlera përfundimtare e masës administrative do të përcaktohet si zbritje e vlerës fillestare të masës administrative me vlerën e kushteve lehtësuese nëse kjo e fundit mund të aplikohet.

Neni 6
Fillimi i hetimit

1. Procedurat e vendosjes dhe ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative". ERE mund të fillojë një hetim për vendosje mase administrative, në rastet kur:

a) ka marrë kryesisht dijeni për një shkelje;

b) vihet në dijeni nga një i licencuar tjetër apo nga një subjekt i interesuar për një shkelje;

c) ka dyshimin e arsyeshëm se kushtet e licencës janë shkelur.

2. Në çdo rast fillimi i hetimit vendoset me urdhër të administratorit apo vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 7
Shqyrtimi fillestar

1. ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje mase administrative, nëse shkelja e pretenduar apo konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 6 muaj që ka ndodhur.

2. Në çdo rast që stafi teknik i cili ka kryer hetimin, konstaton një nga shkeljet e parashikuara në nenin 5, do të përgatisë një informacion/relacion të detajuar mbi shkeljen/et e konstatuara dhe propozimin për fillimin e procedurës për vendosje mase administrative ndaj të licencuarit.

3. Vendimi i Bordit të ERE-s për të filluar procedurën e vendosjes së masës administrative një të licencuari, do t'i njoftohet të licencuarit nga ERE, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s.

4. Njoftimi për vendosjen e masës administrative, do të përmbajë:

- shkeljen e konstatuar;
- masën administrative të propozuar;
- identitetin e të licencuarit;
- dokumentacionin provues ku mbështetet vendosja e masës administrative;
- të drejtën e të licencuarit për të kthyer përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike, nga marrja dijeni, si dhe paraqitjen e argumenteve dhe çdo dokumentacioni shkresor mbështetës në funksion të përgjigjes së tyre apo për qëllime të aplikimit të rrethanave lehtësuese. I licencuari ka të drejtë që brenda këtij afati, të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore për të bërë sqarimet e duhura.

5. Në çdo fazë të një procedimi për vendosje mase administrative, ERE mund të kryejë seanca dëgjimore me të licencuarin dhe subjektin që ka kërkuar kryerjen e hetimit apo ERE mund të kërkojë dokumente të tjera të nevojshme për qëllime të procedurës së nisur.

Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Neni 8
Përcaktimi i vlerës fillestare të masës administrative

1. ERE do të përcaktojë vlerën fillestare të masës administrative brenda kufirit maksimal dhe minimal të vendosur në ligj. Rëndësia e shkeljes do përcaktohet sipas kritereve të mëposhtme:

a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht më parë;

c) rëndësinë e kundërvajtjes;

d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi;

e) nëse kundërvajtësi është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje.

Neni 9
Rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të masës administrative rrethanat e kryerjes së shkeljes do të konsiderohen të lehta, mesatare apo të rënda.

2. Për përcaktimin e niveleve të rrethanave do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:

a) pozicioni hierarkik në kompani i personit që ka kryer shkeljen;

b) mungesa e modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt me qëllim parandalimin e kryerjes së shkeljes;

c) përpjekjet për të fshehur shkeljen.

Neni 10
Subjekti me precedentë dënimi administrativ

Nëse i licencuari është dënuar më parë për shkelje të legjislacionit të sektorit të energjisë, është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje administrative, masa administrative përfundimtare e parashikuar për llojin e kundërvajtjes, do të rritet në masën 10% të vlerës së masës administrative minimale të kriterit përkatës të parashikuar në aneksin 1.

Neni 11
Rëndësia e shkeljes së kryer

1. Për efekt të llogaritjes së rëndësisë së shkeljes së kryer, ato do të konsiderohen të rëndësisë së ulët, mesatare apo të lartë.

2. Për përcaktimin e nivelit të rëndësisë së shkeljes së kryer do të merret për bazë:

a) përfitimi financiar i realizuar nga i licencuari i cili do të llogaritet mbi bazën e raportit të të ardhurave të përfituara me të ardhurat vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit;

b) dëmi i shkaktuar në palë të treta.

Neni 12
Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të masës administrative, pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i të licencuarit do konsiderohen të nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.

2. Për përcaktimin e niveleve të pasojave do merren për bazë kriteret e mëposhtme:

a) dëmi i shkaktuar apo rritja e kostove të shkaktuara konsumatorëve apo pjesëmarrësve në treg;

b) numri i klientëve të përfshirë;

c) rritja e dominancës në treg të të licencuarit;

d) pengimi i punës së Rregullatorit në kryerjen e funksioneve të veta ligjore për monitorimin dhe kontrollimin e të licencuarit.

Neni 13
Lehtësimi nga masa administrative

1. ERE do të konsiderojë se i licencuari plotëson kushtet për lehtësimin në vlerën e masës administrative, kur gjatë hetimit rezulton se ekzistojnë një ose të gjitha rrethanat, si më poshtë:

a) në masën 50 për qind, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet masa administrative, është njoftuar nga vetë i licencuari;

b) në masën 1/3, në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë;

c) në masën 40 për qind, në rastet kur i licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE;

d) do të konsiderohen veprime që çojnë në përmirësimin e tregut, veprimet të cilat pavarësisht shkeljes, kanë ndikuar në përmirësimin e standardeve të shërbimit, konkurrencës, eficiencën në treg etj.

Neni 14
Propozimi përfundimtar

1. Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari brenda afatit të përcaktuar më sipër, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë në ERE, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda afatit të vendosur nga Bordi i ERE-s dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura në përgjigjen e të licencuarit, rrethanat lehtësuese dhe gjithë dokumentacionin mbështetës nëse ka, dhe do t'i propozojnë Bordit të ERE-s përmbylljen e procedurës së nisur për vendosjen e masës administrative, vlerën fillestare të masës administrative dhe nëse ekzistojnë kushtet për uljen e vlerës së masës administrative të propozuar apo mos marrjen e masës administrative ndaj të licencuarit për mos konstatim të shkeljes.

2. Bordi i ERE-s mund të vendosë të mos marrë masë administrative ndaj të licencuarit sipas propozimit të stafit teknik nëse konstaton se faktet e paraqitura nuk provojnë shkeljen.

Neni 15
Vendimi i Bordit

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, Bordi i ERE-s do të vendosë për ndëshkimin ose jo të të licencuarit dhe vlerën përkatëse të masës administrative.

2. Në përfundim të një procedure për vendosjen e masës administrative një subjekti të licencuar, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij, si dhe do t'i dërgojë një kopje të vendimit të Bordit, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

3. Masa administrative e vendosur nga Bordi i ERE-s përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 16
Apelimi i vendimit

Kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve për vendosje të masës administrative, i licencuari mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror". Ankimi ndaj vendimit të ERE-s, për heqjen e licencës apo miratimit, për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje administrative, bëhet sipas ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s në përputhje me rregullore "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore dhe pjesët përbërëse të saj, hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSI 1
TABELA PËR LLOGARITJEN E VLERËS PËRFUNDIMTARE TË MASËS ADMINISTRATIVE

Faza I; Fiksimi i vlerës fillestare të masës administrative, në varësi të rëndësisë së shkeljes			
Kriteret e rëndësisë së shkeljes			
1. Kohëzgjatja e shkeljes dhe shtrirja territoriale e saj	25%	E shkurtër	2%
		E mesme	6%
		E gjatë	12%
		Lokale	2%
		Rajonale	4%
		Kombëtare	%
2. Ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë	25%	I ulët	2%
		I mesëm	6%
		I lartë	13%
3. Përfitimi ekomomik i realizuar nga i licencuari si pasojë e shkeljes	25%	I ulët	4%
		Mesatar	8%
		I lartë	12%
4. Lloji i fajësisë së të licencuarit	25%	Dashje	17%
		Pakujdesia	8%
Faza II: Llogaritja e masës administrative përfundimtare do bëhet sipas formulës: Gj = VFGj-KL Ku GJ = Masa administrative VFGJ = Vlera fillestare KL = Kushtet lehtësuese			
Kushtet lehtësuese	1. Shkelja për të cilën parashikohet masë administrative deklarohet nga vetë i licencuari.		50%
	2. I licencuari bashkëpunon në mënyrë efikase në procesin e investigimit të rregullatorit për shkeljen në fjalë.		33%
	3. I licencuari demonstron se ka bërë veprime që çojnë në përmirësimin e tregut të rregulluar.		40%

VENDIM
Nr. 171, datë 31.10.2016

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s ME NR. 88, DATË 26.9.2011, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË EURON ENERGY GROUP" SHPK, PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE" NR. 187, SERIA T11P

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; nenit 5.2, të licencës "Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; i ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.9.2011, "Mbi licencimin e shoqërisë Euron Energy Group" sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 187, seria T11P,

konstatoi se:

- Shoqëria "Euron Energy Group" sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, përkatësisht me vendimet e Bordit të ERE-s, me nr. 87, datë 26.9.2011 dhe nr. 88, datë 26.9.2011.

- Me shkresën me nr. 268 prot., datë 12.3.2015, shoqëria "Euron Energy Group" sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit te shoqëritë: "Euron Energy" sh.p.k., "Alb Energy" sh.p.k. dhe "Energal" sh.p.k.

- Me vendimin nr. 54, datë 23.4.2015, Bordi i ERE-s ka vendosur transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Euron Group Energy" sh.p.k., te shoqëritë:

"Euron Energy" sh.p.k., "Alb Energy" sh.p.k. dhe "Energal" sh.p.k.

- Shoqëritë "Euron Energy" sh.p.k. dhe "Energal" sh.p.k., kanë aplikuar dhe janë pajisur nga ERE me licencë tregtimi, përkatësisht me vendimet e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 28.7.2015 dhe nr. 91, datë 28.7.2015.

- Me shkresën nr. 1 prot., datë 4.1.2016, kemi marrë dijeni se "Euron Energy Group" sh.p.k., ka pushuar aktivitetin e saj dhe tashmë ka mbyllur edhe procedurat e likuidimit e çregjistrimit nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe pranë organeve tatimore.

- Neni 5.2 i licencës "Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 parashikon se: *"Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor… licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet"*.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.9.2011, "Mbi licencimin e shoqërisë "Euron Energy Group" sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike nr. 187, seria T11P".

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 172, datë 31.10.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË "DENAS POWER" SHPK, NË FAVOR TË BANKËS "SOCIETE GENERALE ALBANIA" SHA

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 6; 7 dhe 8, të rregullores "Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6, të licencës "Për prodhimin e energjisë elektrike", gjithashtu, dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Denas Power" sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të bankës "Societe Generale Albania" sh.a.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Denas Power" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: "a" (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); "b" (veprimtaria e licencuar); "c" (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve); "d"(përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aseti, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); "e" (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); "f" (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); "g" (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar); "i" (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit); "j" (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me germën "h" (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); "j", të pikës 1, të nenit 7 (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt) do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Denas Power" sh.p.k., për lënie peng të aseteve në favor të Bankës "Societe Generale Albania" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 173, datë 31.10.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBTEK ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA "IMPIANTI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE", ME FUQI TË INSTALUAR 2850 kW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa "a" të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d", 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", 4.1.5, germat "a", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me 4.1.5, germa "b" do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga "Impianti i përpunimit të mbetjeve urbane" me fuqi të instaluar 2850 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Mahmut Muhametaj, i datëlindjes 5.8.1939, lindur në fshatin Trevllazër Vlorë dhe banues në Vlorë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shpalljen të vdekur të djalit të tij shtetasit Besho Muhametaj.

KËRKUESI
Mahmut Muhametaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë